

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

T R A N S K R I P T

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 26 QERSHOR 2003

PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,
ODRŽANE 26.06.2003. GOD.

QERSHOR - JUNI



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

RENDI I DITËS

1. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për qasje në dokumentet zyrtare (2003/11)
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e Regjistrimit të të drejtave në pronën e paluajtëshme (2003/14)
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për naftën dhe prodhimet e naftës (2003/18)
5. Shqyrtimi i gjendjes së përgjithshme në arsimin e Kosovës
6. Miratimi i propozimit për emërimin e anëtarëve në komisione parlamentare
7. Parashtrimi i pyetjeve
8. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare me 3 Korrik 2003
 - 8.1 Shqyrtimi i procesit të privatizimit
 - 8.2 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për prokurimin publik (2003/13)
 - 8.3 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për planifikimin hapsinor (2003/15)

Vrejtje : Pyetjet për Qeverinë për përgjigjet me gojë

“Pyetjet për përgjigjet me gojë duhet ti dorzohen Zyrës për parashtrës të paktën pesë ditë pune por jo më shumë se dhjetë ditë pune para kohës kur duhet përgjigjur në to “
(Rregulla 21.2 nga Rregullorja e përkohshme e punës)



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

ДНЕВНИ РЕД

1. Усвајање записника са претходне седнице
2. Друго разматрање Нацрта закона о приступу службеној документацији (2003/11)
3. Друго разматрање Нацрта закона о изменама и допунама Закона о оснивању Регистра права о непокретној имовини (2003/14)
4. Прво разматрање Нацрта закона о Нафти и нафтним производима (2003/18)
5. Разматрање општег стања образовања на Косову
6. Усвајање предлога о именовању чланова у парламентарним комисијама
7. Постављање питања
8. Предлог дневног реда за пленарну седницу од 3 јула 2003
 - 8.1 Разматрање процеса приватизације
 - 8.2 Друго разматрање Нацрта закона о јавним набавкама (2003/13)
 - 8.3 Друго разматрање Нацрта закона о просторном планирању (2003/15)

Опомена : Питања упучена Влади за усмене одговоре

“Питања која захтевају усмени одговор морају да буду достављена у пријемну канцеларију барем пет радних дана, али не више од десет радних дана пре него што се оћекује одговор”
(Правило 21.2 са Привремени пословник)



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

AGENDA

1. Approval of the minutes of previous meeting
2. Second reading of the Draft Law on accessing the official documents (2003/11)
3. Second reading of the Draft Law on the Changes and Fulfilments of the Law on Establishment of the Register on Immovable Property (2003/14)
4. First reading of the Draft Law on Petroleum and Petroleum Products (2003/18)
5. Review on the whole situation of Education in Kosovo
6. Approval of proposal for nomination of the members in the Parliamentary Committees
7. Questions
8. Proposal of agenda for the plenary session of 3 July 2003
 - 8.1 Review on the process of privatization
 - 8.2 Second reading of the Draft Law on the Public Procurement (2003/13)
 - 8.3 Second reading of the Draft Law on the Spatial Planning (2003/15)

Note: Questions to the Government for oral answer

“Questions for oral answer shall be submitted to the Table Office at least five working days but not more than ten working days before they are to be answered” (Rule 21.2 of Provisional rules of procedure)

TRANSKRIPT

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, E MBAJTUR 26 QERSHOR 2003

KRYESUES I SEANCËS, **AKADEMIK NEXHAT DACI**,
KRYETAR I KUVENDIT TË KOSOVËS.

BASHKËKRYESUES, **GOJKO SAVIĆ**, ANËTAR I KRYESISË
SË KUVENDIT TË KOSOVËS.

Seanca filloi punën në orën 10,00.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Mirëmëngjes dhe mirëseerdhët në Seancën e rregullt plenare.

Shpresoj se materialet e dhura për punën e kësaj seance, i keni marrë me kohë.

Që në fillim fjalën e dëshiron Sabri Hamiti. Urdhëroni zoti Hamiti.

SABRI HAMITI:

Zoti kryetar, pajtohem me rendin e ditës. Dua të them vetëm një fjalë për pikën e pestë si të domosdoshme për diskutimin e punës së ministrive. Unë mendoj që në këtë formë, përfundimisht, do të vazhdohet që, siç është premtuar nga Qeveria, të gjitha ministrinë të dalin para Parlamentit me radhë dhe të japin raportet për punën e tyre ashtu siç ka bërë Ministria e Arsimit dhe ashtu siç do të bisedojmë sot për këto probleme. T'falemnderit, zoti kryetar.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Po vazhdojmë me pikat e rendit të ditës.

Në radhë është – Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Nëse ndokush ndien nevojë që gojarisht të bëjë vërejtje, është në rregull, popr parimisht edhe me shkrim munden, siç e kemi praktikuar deri më tani, t'i dorëzohen vërejtjet shërbimeve dhe të korrigojohet.

Pasi që, si duket, nuk ka vërejtje, vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës – Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për qasje në dokumentet zyrtare.

Ju kujtohet se Projektligji është miratuar në parim më 22 maj 2003.

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë bërë rekomandime me amendamente në tekstin e Projektligjit.

Departamenti për mbështetje ligjore dhe procedurale, ka bërë radhitjen e amendamenteve të propozuara nen për nen, tekstin e plotë të amendamenteve, emërtimin e propozuesit dhe qëndrimet e komisioneve relevante lidhur me to.

Prandaj, ftoj kryetarin e Komisionit përkatës funksional, në qoftë se ka diçka të veçantë për të thënë.

Këtu thotë edhe propozuesi i ligjit ka të drejtën e vet dhe unë po shoh se mungon propozuesi i ligjit.

Mirëseardhje edhe ministrave, por tjetrën herë, besoj se as ata nuk do të vonohen, si edhe deputetët.

Prandaj, meqë nuk ka të paraqitur nga komisionet, të shkojmë menjëherë me shqyrtimin e amendamenteve.

Sa për t'ua lehtësuar vendosjen, Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, ka vlerësuar se Projektligji për qasje në dokumentet zyrtare ka bazueshmërinë në Kornizën kushtetuese.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, ka vlerësuar se Projektligji për qasje në dokumentet zyrtare nuk cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Komisioni për buxhet, ka vlerësuar se ligji i përmendur nuk ka implikime buxhetore dhe financiare.

Amendamentet e propozuara, në mënyrë specifike, reflektojnë qëndrimet e komisioneve dhe të Grupit Parlamentar "Kthimit".

Amendamenti 1, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka kundër.

A abstenon ndokush?

Me nëntë abstenime, konsideroj që amendamenti ka kaluar.

Amendamenti 2, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A voton kush kundër? Nuk ka votë kundër.

A abstenon ndokush? 11 abstenime.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 3, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush?

Me 11 abstenime, konsideroj se ka kaluar amendamenti i tretë.

Amendamenti 4, Koalicioni "Kthimi", pa përkrahje nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit. Vetëm 12 vota janë për.

Konsideroj se nuk ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 5, Tre propozime të ndryshme:

- a) Koalicioni "Kthimi", pa përkrahje nga komisionet kryesore;
- b) Komisioni funksional;
- c) Komisioni i buxhetit.

Doni sqarime. Urdhëroni zoti Fatmir Sejdiu, anëtar i Kryesisë.

FATMIR SEJDIU:

Të falemnderit zoti kryetar. Të nderuar deputetë,

Nuk është rast i parë që të dilet me propozime të ndryshme, dhe krejt është normale, ta zëmë në qëndrime rreth amendamenteve. Mendoj se këto amendamente të shtruara në nenin 3 pika 3.2., varianta më e mirë, pavarësisht këtyre arsyetimeve që janë dhënë, është ajo që ka ligji. Dhe, propozoj që ligji të mbetet ashtu siç është, pikërisht neni 3 pika 3.2. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Deputetja Liljana Keniq.

LILJANA KENIĆ:

Ja, naravno, moram da branim naš amandman. Ja sam u prvom našem amandmanu dala pravo svakom fizičkom i pravnom licu. Znači, ovaj zakon treba da garantuje pravo. Vi ste u ovom amandmanu,... zato sam i stavila u drugom amandmanu da se ovaj briše, jer obuhvaćen prvim amandmanom koji nije prihvaćen od vas poslanika. Međutim, ne možete da podvajate građane na one koji imaju prebivalište ili koji nemaju prebivalište ni u skladu sa načelom transparentnosti, odnosno ne možete da kažete «dozvoljava se» nego «imaju pravo». Svi imaju pravo! U unašem prevodu je «dozvoljava se». Znači, to opet zavisi od volje institucije, hoće li ona da dozvoli nekom licu, podnosiocu zahteva, da ima uvid u dokumente ili ne. Eto, toliko.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Mendoj se tani janë katër propozime dhe e vetmja mënyrë demokratike është të përcaktohem me votën e lirë.

Kemi propozimin a) të amendamentit 5 – Koalicioni “Kthimi” pa përkrahje nga komisionet kryesore.

Kush është për këtë variantë. Le të numërohen votat, ju lutem.

Kush është për variantin b) – do të thotë Komisioni funksional.

Kush është për variantin c) – Komisioni për buxhet.

Dhe, propozimi i fundit, ajo që të ngelë ligji i aprovuar në shqyrtimin e parë.

Kush është për?

Ju lutem, nuk do t'a bëjmë, kësaj radhe, numërimin e votave.

Por, do t'ju them. Versioni i parë nën a) ka fituar 14 vota. Domethënë, nuk aprovohet.

Versioni nën b) ka fituar 8 vota. Do të thotë, nuk aprovohet.

Versioni nën c) i Komisionit për buxhet, ka marrë 17 vota. Nuk aprovohet.

Dhe kjo, vetëvetiu nënkupton se mbetet ligji, ashtu siç është.

Ju kërkoj falje. Është lëshim imi.

Amendamenti 6, Koalicioni "Kthimi", pa përkrahje nga komisionet kryesore:

E ka fjalën Liljana Keniq.

LILJANA KENIĆ:

Htela sam da pojasnim, mada smo i u datim amandmanima dali kraće objašnjenje. Ja vas molim da razmislite dobro oko ovog amandmana, jer je suprotan Ustavnom okviru obzirom da su odbrana i vojna pitanja, međunarodni odnosi, javni red i bezbednost isključivo u nadležnosti SPGS-sa – Specijalnog predstavnika Generalnog sekretara odnosno, ja moram da vam pročitam poglavlje 8. tačka 8.2. koji kaže: SPGS treba da ima bljisku kordinaciju sa međunarodnim snagama bezbednosti KFOR-u, tačka c, sprovođenju javnog reda i mira i vršenju funkcija koje mogu da se podvedu pod oblast odbrane, civilne bezbednosti i pripravnosti za vanredne situacije. Dakle, o tim pitanjima isključivo odlučuje i donosi dokumenta SPGS i KFOR.

Ova Skupština ne može o tim pitanjima da raspravlja. Hvala.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Dëgjuam arsyetimin.

Kush është për amendamentin 6, Koalicioni "Kthimi" pa përkrahje nga komisionet kryesore. Le të numërohen votat, ju lutem.

Më lejoni të theksoj se 14 vota janë për këtë amendament. Do të thotë, nuk kalon.

Amendamenti 7, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Urdhëroni...

FATMIR SEJDIU:

Ju falemnderit, zoti kryetar.

Në këtë amendament propozohet që të shtohet edhe një pikë c). Mendojmë se kjo pikë, në këtë rast, nuk ka nevojë të shtohet por të mbetet po ashtu siç është propozuar me variantin e ligjit. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Urdhëroni, e ka fjalën zoti Dugolli.

BUJAR DUGOLLI:

Komisioni ka patur parasysh edhe vërejtjet që i ka paraqitur Zyra ligjore e UNMIK-ut, por edhe vërejtjet apo sygjerimet që i kemi marrë në kuadër të dëgjimit publik për këtë ligj dhe mendoj se ky amendament, me këtë shtesë që është bërë për këto pjesë të rezervuara që qasja në këto dokumente duhet të jetë në koordinim përderisa të jenë pjesë të rezervuara, mendoj se i plotëson edhe ato kërkesa që ligji të nënshkruhet dhe të mos mbetet peng në zyret e UNMIK-ut.

Po ashtu mendoj se është mirë, pasi që ka mbështetje të të gjitha komisionet, të votohet në këtë mënyrë dhe të mos mbetet ai varianti që ka qenë më herët. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Ne na mbetet të vendosim me votim.

Kush është për?

Për kanë votuar 26 votues. Nuk kalon amendamenti dhe mbetet propozimi siç ka qenë.

Amendamenti 8. Dy propozime të ndryshme:

- a) Komisioni i buxhetit;
- b) Koalicioni "Kthimi" pa përkrahje nga komisionet kryesore.

Urdhëroni, nëse doni ta sqaroni, por po më duket se është qartë i theksuar.

Kush është për variantin a) të amendamentit 8? Ju falemnderit shumë.

Kush është kundër? 14 vota kundër.

A abstenon ndokush me këtë rast? 10 kanë abstenuar.

Unë mendoj se kalon amendamenti 8. 14 vota kundër, 10 kanë abstenuar.

...

LILJANA KENIĆ:

Bio bi red da dozvoljite poslanicima da odluče o našem amandmanu, molim vas.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Mirë, i kërkoj falje propozuesit të amendamentit për lëshimin që unë kam bërë.

Kush është për variantin b) të amendamentit 8 të Koalicionit "Kthimi" pa përkrahje nga komisionet kryesore.

13 vota janë për, prandaj kalon amendamenti 8 me versionin nën a).

Amendamenti 9, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Kundër 1 votë.

A abstenon ndokush nga votimi? 13 abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 10, Koalicioni "Kthimi", pa përkrahje nga komisionet kryesore.

Kush është për? 14 vota për.

Konsideroj se nuk kalon amendamenti.

Amendamenti 11, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

Kush është kundër? Nuk ka votë kundër.

A abstenon ndokush? 16 abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 12, Koalicioni "Kthimi" pa përkrahje nga komisionet kryesore.

Kush është për? 14 vota për.

Nuk kalon amendamenti.

Amendamenti 13, Koalicioni "Kthimi", pa përkrahje nga komisionet kryesore.

Kush është për? 16 vota për.

Nuk kalon amendamenti.

Amendamenti 14, Koalicioni "Kthimi" pa përkrahje nga komisionet kryesore.

Kush është për? 14 vota për.

Nuk kalon amendamenti.

Amendamenti 15. Dy propozime të ndryshme:

- a) Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore;
- b) Koalicioni "Kthimi", pa përkrahje të komisioneve kryesore.

Kush është për variantin a) të amendamentit 15? Ju falemnderit shumë.

A ka votë kundër? Një kundër.

A abstenon kush? 8 abstenime.

Kush është për variantin b) Koalicioni "Kthimi" pa përkrahje nga komisionet kryesore.

Kush është për këtë variant të amendamentit 15. 14 vota për.

Kalon amendamenti 15 me variantin a).

Amendamenti 16. Dy propozime të ndryshme:

- a) Koalicioni "Kthimi", pa përkrahje nga komisionet kryesore.
- b) Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për variantin a) të amendamentit 16. 14 vota për versionin a) të amendamentit 16.

Kush është për variantin b) Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore. Ju falemnderit.

Kalon varianti nën b) i amendamentit 16.

Amendamenti 17. Koalicioni "Kthimi", pa përkrahje nga komisionet kryesore.

Kush është për këtë amendament? 14 vota për.

Nuk kalon amendamenti.

Dhe, në fund, ju lutem ta votojmë ligjin në tërësi, sipas amendamenteve të aprovuara. Të pranishëm janë 91 deputetë.

Kush është për? Ju falemnderit shumë.

A ka votë kundër? 14 kundër.

A abstenon ndokush? Nuk ka abstenime. Ju falemnderit.

Me 14 vota kundër, miratohet Ligji ashtu siç është amendamentuar.

Votimi – Glasanje – Voted:

- Për – Za – ForShumica – Veçina – Majority...
- Kundër – Protiv – Against..... 14...
- Abstenuan – Uzdržanih – Abstained... 00...

(Duartrokitje)

Kalojmë në pikën vijuese të rendit të ditës – **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e regjistrit të të drejtave në pronën e paluajtshme.**

Qenka ligji më i mirë për një vit e gjysmë, kështu që është kënaqësi imja t'ju njoftoj se vetëm dy amendamente ka. Ndoshta Ligji i shkurtër, por edhe komisionet kanë punuar seriozisht, prandaj për këtë ju falënderoj të gjithëve.

Po fillojmë menjëherë.

Amendamenti 1. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? 14 abstenime.

Konstatoj se amendamenti 1 kalon. Dhe,

Amendamenti 2. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka kundër.

A abstenon ndokush? 12 abstenime.

Prandaj, konstatoj se amendamenti është aprovuar.

Dhe tani - kush është për Ligjin në tërësi, me amendamentet e aprovuara.
Ju falemnderit. Të pranishëm janë 91 deputetë.

A ka kush kundër? 14 vota kundër.

A abstenon ndokush nga votimi? Nuk abstenon askush.

Votimi – Glasanje – Voted:

- Për – Za – For Shumica – Vecina – Majority...
 - Kundër – Protiv – Against..... 14...
 - Abstenuan – Uzdržani – Abstained..... 00...
-

Konstatohet se Ligji, i amendamentuar, është aprovuar në Parlament.

Kalohet në pikën e katërtë: - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për naftën dhe prodhimet e naftës.

Ftoj ministrin sponsor të Ligjit, profesor Ali Jakupin që të paraqesë fjalën hyrëse.

ALI JAKUPI:

Të falemnderit, zoti kryetar. Zoti kryetar, anëtarë të Kryesisë, deputetë dhe mysafirë të nderuar,

Së pari ju falënderoj që më dhat rastin ta prezentoj para jush Projektligjin mbi naftën dhe produktet e naftës në Kosovë.

Vitin e kaluar, kryeministri dhe unë, kemi diskutuar ligjet që ne shpresonim se Parlamenti do t'i konsideronte në vitin pasues. Njëra prej këtyre iniciativave, ligji mbi naftën, që unë kam nderin ta prezentoj sot, ishte identifikuar si një ligj me prioritet të lartë. Projektligji është një rezultat i konsultimeve gjithëpërfshirëse me ekspertët ligjor ndërkombëtar si dhe ata vendor. Disa prej këtyre ekspertëve kanë një eksperiencë të gjerë në asistimin e vendeve në zhvillim që me sukses të projektojnë dhe të implementojnë ligjet mbi naftën.

Projektligji ka përkrahjen e të gjitha departamenteve relevante të IPVK-ës, UNMIK-ut si dhe të komunitetit ligjor vendor.

Është një pjesë legjislativë e hartuar me profesionalizëm. Shkurtimisht, Projektligji autorizon themelimin e bordit për mbikëqyrjen e karburanteve si një departament brenda Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Bordi do të përbëhet prej 3 anëtarëve të nominuar nga ministri, në konsultim me kryeministrin dhe duke iu nënshtruar konfirmimit nga Parlamenti. Bordi është i autorizuar që t'iu lëshojë licenca tregtarëve me shumicë dhe me pakicë të naftës dhe, ose produkteve të naftës për transport, deponim ose shitje të naftës dhe, ose produkteve të naftës për qëllime biznesore. Aty, nuk ka ndonjë kufizim në numrin e licencave për tregtarë me shumicë dhe pakicë, që mund të lëshohen nga bordi.

Ligji mbi naftën është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e Kosovës, sepse do të ndihmojë në:

1. Sigurimin e pagimit të plotë të përgjegjësve tatimor dhe të detyrimeve fiskale mbi naftën dhe produktet e naftës;
2. Inkurajimin për pjesëmarrje më të gjerë të sektorit privat dhe konkurrencës;
3. Mbrojtjen e konsumatorëve të nafës dhe të produkteve të naftës, dhe
4. Sigurimin e cilësisë dhe sigurimin e furnizimit të naftës dhe të produkteve të naftës.

Kam dëshirë që shkurtimisht të diskutojmë secilën prej këtyre pikave.

Ligji synon pagimin e plotë të përgjegjësve tatimor dhe detyrimeve fiskale. Çdo vit, një numër i kufizuar i importuesve të naftës dhe të produkteve të naftës, qëllimisht, nuk paguajnë detyrimet në import dhe shantazhojnë, në mënyrë të ndryshme, përmes kontrabandimit, raportimit më të ulët, korrupsionit ose mënyrave tjera ilegale. Aktivitetet ilegale, i kushtojnë Kosovës rreth 50 deri 100 milion euro në vit. Asnjë masë nuk mund të sigurojë që këto detyrime do të mblidhen, por megjithatë, ky ligj, është një pjesë e rëndësishme e veprimeve të përbashkëta të rritjes në maksimum të mbledhjes së detyrimeve të importit.

Ligji, inkurajon pjesëmarrjen më të gjerë të sektorit privat dhe të konkurrencës. Vlerësimi transparent dhe dhënia e liçencave tregtarëve me shumicë dhe pakicë, do të ndihmojë në inkurajimin dhe mbështetjen e pjesëmarrjes më të gjerë të sektorit privat në sektorin e naftës, pra në këtë mënyrë, duke ndihmuar në uljen e çmimeve për të gjithë kosovarët. Pra, prej 28 kompanive, vetëm 3 përbënin më tepër se 50% të volumit të naftës së importuar, të transportuar dhe të shitur.

Grupi punues, ka arritur konkluzionin se nën:

- a) edhe pse veçmas ekziston një numër i konsiderueshëm i tregtarëve me shumicë dhe me pakicë, prap është një nevojë e madhe për inkurajimin e mëtutjeshëm të konkuresve të sektorit privat, në sektorin e naftës, dhe
- b) që vlerësim real dhe i paanshëm i dhënies së liçencave edhe më tej inkurajojnë konkurrencën që kujdeset për uljen e çmimeve.

Ligji mbron konsumatorët. Përveç shmangies ilegale të detyrimeve dhe tatimeve, Ligji ndalon tregtarët me shumicë dhe me pakicë që të merren me çfarëdo aktiviteti që përfshin deponimin, reklamimin, ofrimin për shitje ose shitje të naftës ose produkteve të naftës në Kosovë në mënyrë të tillë që ata të mund të mashtrojnë, të kenë prije të mashtrojnë ose kanë efektin e mashtrimit tek shfrytëzuesit e zakonshëm ose përdoruesit në lidhje me: identitetin e prodhuesit të naftës ose prodhimit të naftës; emrin e markës së naftës ose produkteve të naftës; emrin ose identitetin e tregtarit me pakicë; çmimin e naftës ose prodhimin e naftës; dhe, ose përbërjen, gradën ose kuantitetin e naftës ose të derivateve të naftës.

Tregtarët me shumicë dhe pakicë, kanë të ndaluar që të mbajnë, ofrojnë për shitje ose sheshin naftë, ose produkte të naftës, nga cilido kontejner, rezervuar, pompë ose ndonjë mjet tjetër distribues i ndryshëm prej atyre të prodhuar ose distribuar nga prodhuesit dhe

distributori i ndikuar nga emri, marka, tregtia, simboli, shenja ose ndonjë shenjë tjetër dalluese ose pajisje që paraqitet në një rezervoar, kontejner, pompë ose mjet tjetër distribues të tillë në të cilin produktet e tilla shiten, ofrohen për shitje ose distribuohen.

Ligji ndihmon që të sigurohet cilësi, siguri dhe siguri të furnizimit të naftës dhe të produkteve të naftës. Ligji mundëson një diskutim për mënyrën e themelimit të një rezerve strategjike të karburanteve, të zvogëlojë nxjerrjen e dëmshme për ambientin e veturave dhe të rrisë standardet e cilësisë për të arritur standardet e Bashkësisë Evropiane në një kohë që është konsistente me zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Për ta zbatuar ligjin, bordi mund të aplikojë, tek një gjykatë me juridiksion kompetente që të ndalojë personat prej angazhimit me praktikë mashtruese tregtare, ose që të aplikojë tek një gjykatë me juridiksion kompetent që menjëherë të ndalohet shitja dhe të parandalohet shitja e mëtejme nga një pompë shpërndarëse e naftës, ose ndonjë mjet tjetër shpërndarës, prej të cilit nafta ose produktet e naftës ofrohen për shitje, në kundërshtim me këtë ligj.

Në përmbledhje, Projektligji është shumë me rëndësi për ndihmesën e Kosovës që të arrijë qëllimet e saja afatshkurtëra dhe afatgjata ekonomike.

Për këtë arsye, unë fuqishëm rekomandoj miratimin nga Parlamenti në këtë formë.

Edhe një herë ju falënderoj për këtë mundësi që t'i adresohem Parlamentit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit, ministër. Unë do t'ju thoja se shqyrtimi i parë është në parim. Prandaj, e ka fjalën zoti Bajrush Xhemajli, kryetar i Komisionit. Le të përgatitet Fatmir Rexhepi.

BAJRUSH XHEMAJLI:

E nderuar Kryesi, të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputetë,

Unë dola këtu në cilësinë për Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike, jo si kryetar Komisioni. Ne jemi aq demokrat sa kemi tolerancë, ka një tolerancë shefi i Grupit Parlamentar, prandaj ne edhe ashtu mund të jemi të gjithë shefa të grupit parlamentar përka njohuritë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, përkrahë nismën për miratimin e këtij ligji, që është shumë i rëndësishëm. Por, duke lexuar Projektligjin, kemi vërejtur lëshime esenciale, të natyrave të ndryshme.

Që në fillim atje, te neni 2.1, ta zëmë definicioni për naftën është i gabueshëm, madje konsiderojmë i gabueshëm plotësisht kur thuhet se «nafta nënkupton naftën e papërpunuar, lubrifikantët dhe hidrokarburet tjera të papërpunaura». Në fakt, dihet se nafta është me përzierje hidrokarburesh me prejardhje natyrore, apo «sektor të naftës». Ky term, mendoj është kopjuar diku ku prodhohet nafta, ku janë derivatet e saj, e tjera. Këtu thuhet, «sipas propozimligjit industria e naftës dhe e prodhimeve të naftës në Kosovë», kuptohet në sektor

të naftës. Edhe pse dihet se në Kosovë nuk ka industri të naftës dhe as derivate të sajë. Në fakt, në Kosovë vetëm tregtohet me naftë dhe derivate të naftës.

Në nenin 11.3, thuhet «shitësit me shumicë dhe me pakicë, me vetëdije nuk do të përdorin mjete matëse jo të sakta». Këtu do të thotë i lëhet vetëdijes tash kur të gjykohet, me vetëdije apo pa vetëdije që nënkuptohet do të thotë se ata që shesin pa vetëdije nuk do të dënohen. Ata që shesin me vetëdije, domethënë gabimisht, ata do të dënohen, gjë që nuk është parë në praktikën juridike sepse vjedhja nuk mund të ndahet. Vjedhja është vjedhje, pastaj gjykatësi shikon atje punët e veta.

Sa i përket propozimligjit, pothuaj se nuk ka strukturë ligjore. Këtë e kanë thënë juristët e Grupit Parlamentar, sepse unë nuk jam jurist por nuk ka strukturë të qëndrueshme, së paku...

Dua të theksoj se ky propozimligj mbi tregtimin e naftës dhe derivateve të naftës, siç do të duhej të ishte, në fakt është një si urdhëresë apo rregullore e ministrisë për një bord, për njëfarë bordi që është i caktuar aty, që do të mbikëqyrte tregtinë me naftë dhe me derivate të sajë. Vetëm dy nene nuk kanë të bëjnë me këtë bord.

Konstatojmë se ligji i propozuar, që nga neni 3 e deri te neni 11.5, nuk do të mund të ishte i zbatueshëm askund në shtete në transicion me ekonomi të tregut, prandaj janë të paqëndrueshme. Bordi do të kishte superkompetenca dhe do të dilte mbi ligjin, ku mund të krijojë hapësirë dhe mundësi për keqpërdorime gjatë lëshimit dhe vëzhgimit të licencave.

Është interesant të shikohet edhe neni 9, lidhur me rishqyrtimin e ankesave ndaj vendimit të bordit. Në propozimligj shkruan – «çdo person i cili nuk pajtohe tme vendimet e bordit, mund të ankohet në bord për rishqyrtimin brenda 45 ditëve, që nga dita e marrjes së vendimit të bordit». Ankesat në këtë rast do t'i shqyrtonte i njëjti bord... (ndërprerje momentale e tonit në foltore)...

Bordi pra i jep vetes të drejtë të prejudiojë se kush është shkelës i ligjit, kush duhet të paraqitet para organit të policisë, organeve hetimore dhe atyre gjyqësore, në vend se me ligj të parashihen dispozitat sanksionuese me dënim në të holla për shkelje të vogla, me gjoba të vogla dhe me dënime të mëdha ose të ndërprerje të përkohshme të veprimtarisë.

Pothuaj se tërë ligji mirret me formimin e bordit, që edhe ashtu është i panevojshëm, mendojmë, meqë pranë Ministrisë është departamenti për tregtimin e naftës dhe derivateve të saj.

Megjithatë, duke patur parasysh rëndësinë e këtij ligji, me vërejtjet e lartpërmendura, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, propozon që propozuesi t'i marrë parasysh leximin e dytë dhe bashkë me Komisionin funksional t'i eliminojë ato. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit, Bajrush. Fatmir, kërkoj falje, anëtarët e Kryesisë në çdo kohë kanë përparësi me Rregullore. Le të urdhërojë Oliver Ivanoviqi.

OLIER IVANOVIĆ:

Poštovane kolege, uvažavajući značaj ovog zakona, uvažavajući potrebu za postojanje, naime, ovakvog zakona ja moram da krenem od nečega što je u ovom trenutku jako važno.

Ja, nažalost nisam pogledao albansku i englesku verziju pa ne mogu da uporedim to troje, ali govorim da srpska verzija ne ostavlja mnogo mesta da mi o tome diskutujemo. Prosto, jer u naslovu zakona ne stoji da li se radi o prometu ili o prometu i proizvodnji. Sad sam, u konsultacijama sa ministrom, jasno. Ja znam da ne postoji nafta kod nas i da mi ne možemo proizvoditi naftu, ali zakon mora da bude vrlo precizan po tom pitanju. Znači, prvo predlažem da se zakon, kao takav, u srpskoj verziji zove – Zakon o prometu nafte i naftених производа, umesto ovoga što stoji kao ponudeni naslov zakona.

Druga stvar, ja moram da kažem da zakon u ovoj formi, kako je napisan, jednostavno je nerazumljiv. Mi imamo, rekao bih, puno dobre volje i mislimo da bi smo za ovaj zakon glasali u principu, ali ovakvim tekstom, to je apsolutno nedopustivo. Ja moram da kažem da nisam video, ponovo ponavljam, nisam video ni albansku ni englesku verziju ali sam ubeđen da ona takođe obiluje obiljem grešaka.

Samo malo strpljenja. Ja ću va vama pročitam samo jedan od par članova i da vidite na šta to liči. Oni koji malo bolje govore srpski će jasno videti šta znači.

Prvo, oko definicije, ovako. Kaže: «Bord imaće upravu i odgovornost da». Uprava je termin za lideršip, za menadžment uprava. Imaće pravo, to je bitna razlika. To jednostavno ne može da se podvede pod običnu tehničku grešku. Da ne čitam detalje, kaže: «licencacija». Nikad, u životu, takvu reč... Ja ne znam ni na engleskom da bi takva mogla da izgleda. To je pokušaj da se prenese čisto kompletna engleska reč.

Samo sam odabrao neke karakteristične... Ili kaže: «Da nije mu oduzeta», to izgleda kao iz Prizrena... «da nije mu oduzeta, suspendirana licenca na dve ili više puta ili revocirana od strane borda». Da vam kažem, ovo bukvalno, ja ne bih to nikako mogao da razumem, pored najbolje volje.

Kaže, obnavlja licencije i tako dalje. «Suspencacije i revokacije licence». Ajde, razumite vi sada šta to znači. To stvarno... Ja bih zamolio ovako da ako je to moguće prođe kroz dobar prevod do odlaska na odbore, ne da ide na odbore, pa da onda posle toga prevodimo, jer to nije u redu. Mislim da smo malo neozbiljni kao institucija, nego da, znači do odlaska na odmone, doživi jedno korenitu promenu u pogledu prevoda i da odbori dobijaju prečišćeni tekst. Hvala. Inače, u principu mi bi smo verovatno glasali za. Hvala.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Një qoftë se kanë shefat e grupeve parlamentare le të paraqiten. Urdhëroni, po mundeni në emër të grupeve parlamentare.

NAIM MALOKU:

I nderuar zoti kryetar, të nderuar zotri ministra, deputetë të nderuar, zonja dhe zëtorinj,

Dihet se Kosova nuk ka rezerva të naftës të veta dhe nuk prodhon naftë. Mirëpo, fakti se dikund rreth 25 milion euro në muaj shpenzohen për derivate të naftës në Kosovë, e që do të thotë 300 milion euro në vit, tregon se çfarë rëndësie ka të bëhet një ligj i cili rregullon në mënyrë të qartë dhe decisive raportet në treg, shitësi me shumicë, pakicë, blerësi dhe të gjitha raportet që hyjnë në tregti me naftën.

Me interesim të veçantë edhe personalisht e kam pritur një ligj të tillë. Mirëpo, më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, t'i jap disa vlerësime dhe vërejtje në këtë ligj.

Përmendet dhe thuhet "për nevojat e rezervave strategjike". Propozoj që me këtë çështje të merremi në mënyrë më konkrete. Propozoj që në ligj të përcaktohen rezervat emergjente, që do të thotë sasia e shprehur në përqindje të kapacitetit të përgjithshëm të rezervuarve apo cisternave të shitësve me shumicë dhe pakicë, cisternave statike pra, 5 deri 10% duhet të jenë rezerva të paprekshme që hyjnë në rezervat emergjente. Ne nuk kemi mundësi me bërë rezervuar edhe për shumë vite për rezerva strategjike. Pra, rezervuarët ekzistues duhet të përcaktohen me ligj dhe që ti kemi rezervat emergjente. Ato rezerva duhet të shfrytëzohen në raste të çrregullimeve të mëdha në treg, katastrofave natyrore dhe rasteve tjera emergjente, të cilat ajo rezervë do të siguronte funksionimin e shërbimeve vitale të shoqërisë, pushtetin lokal, qendror, Shërbimi Policor i Kosovës, TMK, Shërbimi i Zjarrfikësve, spitalet, ndihma e shpejtë e tjera. Pra, për të funksionuar shoqëria kosovare në rastet emergjente. Ky kapitull duhet të jetë i veçantë në ligj, me të cilin duhet të merret edhe departamenti i emergjencës dhe sigurisë civile pranë Ministrisë së Shërbimeve Publike, pastaj komisioni parlamentar për emergjencë dhe siguri civile në Parlamentin e Kosovës. Këto rezerva janë shumë të rëndësishme. Në ligj duhet të përcaktohen edhe dënimet në qoftë se shitësit me shumicë dhe pakicë i prekin këto rezerva. Ato janë të paprekshme, pra dënohen. Ato preken vetëm me leje të posaçme që duhet të përcaktohen me ligj si dhe në çfarë mënyre apo kur preken ato rezerva.

Më lejoni të them se bordi, që e tha ministri në fjalën e tij, se në konsultim me kryeministrin... Ajo nuk qëndron në ligj! Unë dua t'ua lexoj se si është paraparë emërimi i bordit me urdhëresë, pra kemi emërim të bordit me urdhëresë të ministrit, që thotë: "jo më vonë se 35 ditë prej ditës së hyrjes në fuqi, ministri do të lëshojë një urdhëresë të ministrisë për themelimin e bordit". Kjo është e tëra, pra nuk ka konkurs, nuk ka kushte të cilat duhet të plotësojë një anëtar i bordit, nuk ka kurgjë dhe kjo bëhet vetëm me urdhëresë të ministrit.

Ju lutem, në katër vjetët e kaluar, pas luftës, jemi dëshmitarë të them sinqerisht të plaçkitjeve që iu kanë nënshtruar qytetarët e Kosovës në të gjitha pompat e benzinës, pra në shumicën e pompave të benzinës. Shitësit i kanë mjetet matëse të pakalibruara. Ligji nuk parasheh... dhe duhet patjetër në çdo gjashtë muaj të bëhet kalibrimi i domosdoshëm i pajisjeve, mjeteve matëse dhe duhet të liçencohet firma e cila e bën – jo ministria por firma e posaçme e cila bën kalibrimin, do të thotë është e obligueshme me bë, ka të drejtë me bë kalibrimin e pajisjeve matëse. Dua t'ju them dhe njoftoj se vetëm me rregullimin e

pistoletës ku ne marrim naftën deri në 20%, do të thotë, marrim lëndëdjegëse më pak se sa paguajmë.

Ky ligj, me nenin 1.4, i mbron këto abuzime, më falni, i mbronë! Dua t'i lexoj. Më falni ll.3. "Shitësit me shumicë dhe shitësit me pakicë, me vetëdije nuk do të përdorin mjete matëse jo të sakta". Pra, në qoftë se rastësisht ndonjë qytetar ankohet dhe zëhet një shitës që mjetet matëse nuk i ka të sakta, atëherë praktikisht edhe pse ai shitës i ka shitur një milion litra dhe ka vjedhur 200 mijë, atë nuk ka ligj a gjyq që mundet me ia vërtetua se ka bërë këtë me vetëdije. Unë po them dhe konstatim imi është që ky nen dhe ky paragraf mbron vjedhjet dhe abuzimet në tregun e Kosovës. Këto duhet të jenë me ligj decidivisht të sakta dhe dënimet në qoftë se me komisione apo inspeksione, që ligji nuk përmban këto, pra nuk ka në vete inspeksionet e tregut me naftën. Duke marrë parasysh parametrat e kualitetit të naftës a mbahen parametrat, parametrat konstant.

Ne kemi edhe tjetrin abuzim që bëhet në këtë njet të tregtisë me naftë. Shitësi me shumicë ia shet atij me pakicë, derdhen 20 ton në një rezervoar të pompës së benzinës, i shtohet një ton ujë. 5% ne marrim pastaj ujë. Do të thotë nuk ka inspeksion që bën përcjelljen e parametrave të naftës, kualitetit të naftës nga hyrja, shitjes me shumicë dhe deri te ata me pakicë dhe kjo duhet të bëhet me inspeksion të rregullt dhe befasishëm dhe duhet të jenë dënime shumë të larta për shkeljet e këtyre ligjeve. Unë po zgjas pak, më falni, por vërtet jam i shqetësuar me një ligj të tillë.

Dua t'ua lexoj, ju lutem, edhe nenin 14.2. Dëgjone mirë. "Shërbimin policor", mendohet ndoshta në Shërbimi Policor i Kosovës, "dhe agjencionet tjera për ekzekutim do të kenë autoritetin që të zbatojnë çdo dispozitë në këtë ligj që mendohet të jetë vepër kriminale". Është fakt, Shërbimi Policor i Kosovës, duhet të merret me ne edhe në qoftë se i miratojmë këto dispozita, sepse thjeshtë vetëm ky nen dhe ky paragraf i përgjigjet këtij ligji.

Personalisht, dhe në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës, mendoj se ligji duhet të kthehet në një përpunim të mirë, të marrin pjesë të gjithë në hartimin e tij.

Dhe krejt në fund, zoti kryetar, të nderuar deputet, shumë shtete dhe parlamentet e atyre shteteve, i kanë në kontroll dhe i përcaktojnë çmimet e derivateve të naftës, të cigareve, pijeve alkoolike dhe shërbimeve telefonike. Me lëvizjen e atyre çmimeve, parlamenti vendos në mbulimin e rebalanceve të buxheteve të shteteve, pastaj bën edhe investime kapitale, pra nxjerr financa që të bëhen investime kapitale me interes të shoqërisë.

Kur ky Parlament do t'i vëjë nën kontroll këto shërbime dhe këto çmime?
Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Do t'ju lutja për vëmendje. Kam një propozim për sintezën e asaj që u tha deri tash. Në aspektin teknik, nuk janë të plotësuara kushtet që çdo deputet të japë kontributin e vet të duhur. Koalicioni «Kthimi» ka vërejtje aq substanciale sa që nuk kuptojnë ligjin, prandaj atë që tha edhe zoti Ivanoviq, duhet të jetë në konsideratë. Mendimet edhe të grupeve parlamentare janë për afërsisht në këtë vijë dhe mendoj që të mos vazhdojmë debatin e mëtejshëm. Le të tërhiqet ligji në përpunim teknik dhe ato çështje tjera dhe Qeveria le ta ketë këtë parasysh.

Po ju them, Kryesia, herën e kaluar e ka hequr prej rendit të ditës një ligj tjetër, prandaj të mos debatojmë më. Le të hiqet prej rendit të ditës, të japim një pauzë njëorëshe dhe pastaj le të dihet si duhet vepruar.

Urdhëroni, si shef i Grupit Parlamentar, keni të drejtë dhe urdhëroni, zoti Hamiti.

SABRI HAMITI:

Ashiqare, argumentimet e të gjitha diskutimeve të grupeve parlamentare që biseduan deri tash dhe natyrisht edhe të tërëve, e të LDK-ës që tash për tash s'e morën fjalën sepse po duket se po shkon kah një koncensus që ligji, edhe në emërtimin, edhe në materien që ka ndërtuar brenda, pastaj edhe në pikat themelore të tij, nuk është në gjendje që të diskutohet më tutje. Unë, në emër të Grupit Parlamentar tonin, vetëm mbështes këtë. Por, domethënë, e mbështes qëndrimin që sot të mos kalojë ky ligj. Por, po ashtu, mbështes qëndrimin që shumshpejt të kthehet në Parlament, varianti i përpunuar i ligjit, ju lutem. Sepse, u pa nga diskutimet sa është materia e domosdoshme që të përpunohet shpejt. Sidomos u kualifikua sakt nga deputeti Maloku krejt kjo problematikë. Kështu që, unë mendoj se s'kemi nevojë të kemi dyse: – ta pranojmë se është varianti shumë i keq dhe hajt ta kalojmë!

Unë pajtohem me kryetarin e Kuvendit që të mos kalohet sot ligji, por në të njëjtën kohë po them me rekomandim që shumshpejt sepse u pa çka duhet të ketë aty që kjo të kthehet. Të falemnderit, zoti kryetar.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Edhe zoti Saviq, si anëtar i Kryesisë dhe të bëjmë një pauzë.

GOJKO SAVIĆ:

Poštovano Predsedništvo, dragi poslanici. Ja se u potpunosti, zaista, slažem sa predsednikom da se ovaj zakon vrati na doradu. Ima, zaista, vidljivih zamerki koje bi trebalo otkloniti ali uz, ja bih predložio, još jednu sugestiju. Naime, s obzirom da na Kosovu je evidentno da nema eksploatacije nafte, evidentno je takođe da nema rafinerije nafte, ja bih predložio Radnoj grupi da prilikom sastavljanja naslova predloga ovog Nacrta zakona dođe do nekih izmena i da to bude onako, u onom pravom smislu, kako bi trebalo. Recimo, imam predlog, recimo: Nacrt zakona o prometu naftnim derivatima, ili proizvodima. I onda taj zakon obuhvata sve to što je vezano za ove prostore. Hvala.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Tani po bëjmë një pauzë. Në ora 12 vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

(Vijoi pauza)

(Pas pauzës, seanca vazhdoi punën).

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju lutem, po vazhdojmë punën.

Në rend të ditës është: - **Shqyrtimi i gjendjes së përgjithshme në arsimin në Kosovë.**

Në fillim do të doja që ministri ta jepë një fjalë hyrëse e pastaj kryetari i Komisionit për arsim, shkencë e teknologji. Zoti iministër urdhëroni, fjala është e juaja.

REXHEP OSMANI:

I nderuar zoti kryetar, të nderuar deputetë,

Kam kënaqësinë që mu dha rasti të prezentoj Raportin e punës njëvjeçare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë sipas marrëveshjes kur është bërë fjalë për Raportin e punës së Qeverisë së Kosovës, që ministritë, në mbledhje të radhës, herëpsherë mund të ftojnë ministrat për të raportuar për punën e tyre.

Meqenëse deputetët kanë marrë këtë Raport para një muaj e më tepër, dhe besoj se të gjithë e kanë lexuar, unë vetëm po i përmendi disa pika kyçe të raportit dhe, besoj nuk do të zgjas shumë.

Qëllimi i këtij Raporti është paraqitja e punës njëvjeçare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Në një kontekst të caktuar kohor si vazhdimësi e punës së Departamentit të Arsimit dhe të Shkencës, Ministria e Arsimit, të Shkencës dhe Teknologjisë, institucion i Qeverisë së Kosovës, përgjegjës për krijimin e politikës drejtuese të sistemit të arsimit në Kosovë, u themelua më 4 mars 2002. Në kohën e themelimit të Ministrisë së Arsimit, kushtet socio-politike dhe arsimore në Kosovë ishin të paqëndrueshme. Ishte koha kur në këtë kontekst në shoqërinë kosovare ndihej nevoja dhe njëkohësisht... (planifikoheshin).... ndryshime të mëdha. Institucionet përkatëse të Qeverisë së Kosovës së Kosovës kishin marrë mandatin që këto veprimtari t'i planifikonin mirë, t'i organizonim, t'i drejtonim e t'i zbatonim në mënyrë profesionale. Kjo ishte një sfidë e madhe për Qeverinë e Kosovës, por në veçanti për Ministrinë e Arsimit, Shkencës e Teknologjisë, që drejton fushën më të ndieshme dhe më të rëndësishme në kohën e ndryshimeve të mëdha në shoqëri, atë të sistemit të arsimit. Marrjen e përgjegjësisë për zhvillimin e sistemit të ri të arsimit, me qëllim që të sigurohet një arsimim më i mirë për të gjithë, një qasje e barabart për të gjithë, pa dallim përkatësie etnike, fetare, politike, sociale, gjinore e tjera. Kjo është një sfidë dhe përgjegjësi e madhe për shoqërinë kosovare, por edhe për bashkësinë ndërkombëtare, meqë Kosova, me zhvillimet cilësore në fushën e arsimit, mendon të krijojë një realitet bashkëkohor, një pamje të re, në përputhje me synimet e shoqërisë kosovare për integrim me strukturat dhe mekanizmat ndërkombëtar.

Meqenëse Raportin e kanë të gjithë deputetët, unë po përmendi vetëm se Ministria, që nga fillimi veprimtarinë e ka bazuar në një udhëheqje profesionale të sistemit të arsimit, duke sajuar një plan të veprimit, i përqëndruar saktësisht se çfarë rezultatesh dëshiron të arrijë në këtë fazë të zhvillimit, me qëllim të përmbushjes së nevojave për ndryshime, duke iu shmangur udhëheqjes institucionale sipas rastit.

Kështu, për vitin e parë të veprimit, Ministria e Shkencës dhe Teknologjisë, planifikoi t'i arrijë këto objektiva apo rezultate:

- kompletimin e infrastrukturës bazë të rregullativës ligjore;
- ndërtimin, zgjerimin dhe renovimin e objekteve shkollore në të gjitha nivelet e shkollimit;
- zbatimin e sistemit të ri të arsimit;
- zhvillimin e planprogrameve të reja mbi bazën e standardeve ndërkombëtare në të gjitha nivelet e shkollimit;
- hartimin dhe botimin e teksteve mësimore;
- aftësimin e mësimitdhënësve për zbatimin e metodologjive të reja në procesin e mësimitdhënies dhe të mësimitnxënies në të gjitha nivelet;
- pajisja e shkollave me mjete të nevojshme mësimore;
- ngritja e qendrave për udhëheqjen e sistemit të informimit në arsim;
- përmirësimin e kushteve për rritjen e vijimshmërisë së nxënësve në shkollë;
- përmirësimin e bazës materiale dhe kushteve të punës për të gjithë punëtorët e arsimit, nxënësit dhe studentët;
- vazhdimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në të gjitha fusha të arsimit;
- zhvillimi i projekteve të ndryshme në zhvillimin e arsimit dhe prezentimin para donatorëve ndërkombëtar;
- riorganizimi i administratës në institucionet e arsimit, në pajtim me rregullativat ligjore, e tjera.

Ndërsa, si pikë kyçe të zhvillimit të strategjisë së re, që është duke përgatitur Ministria, ka të bëjë me unifikimin e sistemit të arsimit, sigurimin e hapësirës së nevojshme shkollore për të gjitha nivelet, sigurimin të arsimit për të gjithë, arritje në rezultateve të pranueshme të nxënësve në të gjitha nivelet e shkollimit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe inkurajimi i prindërve dhe shoqërisë në përgjithësi në mbështetje të arsimit dhe informimi publik për rezultatet dhe vështirësitë në sistemin e arsimit.

Meqenëse deputetët kanë raportin e hollësishëm lidhur me këtë, unë kisha për t'u ndalur vetëm edhe në dy-tri çështje që kanë të bëjnë me një informatë të shkurtër për punën e

ministrisës ë arsimit, të shkencës dhe teknologjisë në tremujorin prill-qershor, në mënyrë që të bëhet një lidhshmëri e raportit të punës deri në mars.

Gjatë periudhës prill-qershor 2003, Minsitria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, vazhdoi me aktivitetet e veta të parapara sipas planit vjetor për realizimin e synimeve të parashtruara në Planin strategjik 2002-2007. Kjo periudhë u karakterizua me vazhdimin e disa projekteve të nisura gjatë vitit të parë të veprimit të Ministrisë së Arsimit, por edhe me rumbullaksim të përfundimit të suksesshëm të projekteve të tjera në përputhje me dinamikën e planifikuar të veprimeve për këtë periudhë.

Më poshtë, po japim një pasqyrë të shkurtër të këtyre aktiviteteve.

Në kuadër të strategjisë për bashkëpunim me donatorët dhe partnerët ndërkombëtar, prej datës 22 deri 25 maj, Ministria organizoi Konferencën ndërkombëtare me donatorë. Është vlerësim i njëzëshëm i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, por edhe i partnerëve ndërkombëtar se Konferenca ishte e suksesshme dhe i arriti qëllimet e parashtruara:

- të komunikohet me donatorët dhe ekspertët ndërkombëtar lidhur me rrugën e cilësisë së reformave të arsimit në Kosovë, pas themelimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës e Teknologjisë;
- të sigurohet vazhdimësia e kontakteve dhe përkrahjes së donatorëve për projektet e Ministrisë në zhvillimin e mëtejshëm të procesit të reformave në arsim;
- të paraqiten projektet prioritare të Ministrisë dhe të diskutohet përputhshmëria e tyre me prioritetet e interesimit të donatorëve; dhe
- të prezantohet Plani strategjik i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për vitin 2000-2007.

Unë mendoj se në një mbledhje të radhës, Parlamenti i Kosovës, do të mund të miratojë edhe dokumentin e përgatitur nga Minsitria për strategjinë e zhvillimit të arsimit, shkencës, teknologjisë në periudhën 2002-2007.

Gjatë kësaj Konference, u konfirmua vullneti i donatorëve kryesor për vazhdimin e mbështetjes për arsimin kosovar. U vlerësua shumpozitive rruga e deritashme e Ministrisë së Arsimit në zhvillimin e reformave, si dhe u vlerësua lart strategjia e Ministrisë për vitin 2002-2007. U krijuan kontakte me donatorë të ndryshëm, të cilët shprehnin interesim për mbështetjen e projekteve të tjera të Ministrisë.

Fillimisht, Konferenca për a gjencitë kosovare të a kreditimit, që është mbajtur po a shtu para një muaji, fillimisht e planifikuar si seminar për përvojat ndërkombëtare në lëmin e akreditimit dhe të vlerësimit. Kjo ngjarje është organizuar nga Ministria, Sorosi dhe Qendra Kosovare e Arsimit u shndërrua në një konferencë shumcilësore ndërkombëtare me rëndësi për rajonin sa i përket akreditimit dhe vlerësimit të institucioneve të arsimit të lartë. Në Konferencë morrën pjesë ekspertë nga Kosova, Shqipëria, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britania e Madhe, Franca, Gjermania, Maqedonia, Mali i Zi, Kroacia, Sllovenia si dhe institucione të ndryshme relevante ndërkombëtare: OCD-ea, Banka Botërore, Fondacioni dhe Bashkësia Evropiane. Punimet e saj u vlerësuan shumë të suksesshme nga të

gjithë pjesëarrësit dhe u cilësuan në vijat e veprimit për themelimin e agjencisë kosovare të akreditimit dhe vlerësimit sipas Ligjit mbi arsimin e lartë.

U organizuan edhe dy seminare me nga 200 pjesëmarrës, ekspertë vendor e ndërkombëtar, të cilët bënë hartimin e versioneve përfundimtare dhe të programeve lëndore për klasën e parë, gjashtë dhe të dhjetë. Puna në zhvillimin e programeve, e organizuar në seminare dhe punë ekipore në mes dy seminareve është vlerësuar tejet e suksesshme si nga ekspertët vendor ashtu edhe nga ekspertët e shumt ndërkombëtar nga Sllovenia, Shqipëria, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britania e Madhe dhe Kanadaja.

Është hera e parë që në Kosovë angazhohen një numër kaq i madh i ekspertëve më të mirë vendor në një proces kompleks e të gjatë. Angazhimi dhe puna e tyre e palodhshme janë garancë për cilësinë e programeve të reja mësimore në Kosovë.

Versioni përfundimtar i programeve do t'u dorëzohet Këshillit të ekspertëve për programin e pjesës së dytë të korrikut kur edhe do të miratohen.

Po ashtu, janë bërë edhe disa punë tjera të cilat, për shkak, mendoj se duhet t'i kaloj.

Participimi i studentëve në Universitetin e Prishtinës dhe shpenzimet e studimeve

Spektori i financave ka kryer të gjitha përgatitjet për mundësimin e kryerjes së pagesave ndaj studentëve të liruar nga pagesa studentët e shkëlqyeshëm, si dhe ndaj mësimdhënësve të Universitetit të Prishtinës sipas dispozitave të udhëzimit përkatës administrativ. Tash për tash mbetet që administrata e Unviersitetit të Prishtinës të bëjë veprime të duhura për kryerjen e obligimeve ndaj studentëve dhe mësimdhënësve.

Departamenti i infrastrukturës ka përgatitur projekte të plota prioritare për zbutjen e gjendjes së vështirë lidhur me lokalet shkollore në qendrat urbane. Këto prioritete janë vendosur duke u bazuar në dokumentin e Minsitrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë që rregullon politikën e Ministrisë në lëmin e infrastrukturës dhe në listën e prioriteteve të dorëzuara nga komuant e Kosovës. Kështu, janë përgatitur mëse dhjetë projekte për ndërtim në qendrat urbane me mbingarkesë të theksuar të lokaleve shkollore.

Pos këtyre, kanë vazhduar edhe aktivitete të tjera të cilat janë të nevojshme për Minsitrinë e Arsimit, të Shkencës dhe Teknologjisë.

Që mos t'iu marrë kohë deputetëve, unë jam në dispozicion për pyetjet dhe përgjigjet lidhur me këtë. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Zoti ministër, ju falemnderit. Është paraqitur numër shumë i madh i diskutuesve. Fjalën e ka kryetari i Komisionit funksional. Pastaj, lutja ime do të ishte që të shqyrtohen rekomandimet që janë bërë nga komisionet, shefat e grupeve parlamentare diagnostikën e përgjithshme nëse e shofin dhe të mos përsëriten, ju lutem, vlerësimet. Zoti Kuqi, kryetar i Komisionit funksional e ka fjalën.

HAJREDIN KUQI:

I nderuar zoti kryetar, të nderuar deputetë, të nderuar ministra, zonja dhe zotërinj,

Jam i nderuar që në emër të Komisionit për arsim, shkencë dhe teknologji, t'i paraqes disa propozime dhe rekomandime të këtij Komisioni, të cilat, që në fillim, mund të themi se janë punë e përbashkët e komisionit dhe janë arritur me konsensus brendapërbrenda Komisionit. Prandaj, edhe dua t'i falënderoj për bashkëpunimin e mirë dhe konsensusin e arritur të të gjithë anëtarëve pa përjashtim.

Mund të them se kjo pikë e rendit të ditës ka ardhur si rezultat ...i kërkesës së Komisionit për arsim, shkencë dhe teknologji, i cili, në radhë të parë, ka pasur parasysh planin e vet të punës, të miratuar në shkurt të këtij viti dhe kemi pasur për qëllim që të bëhet një diskutim i gjendjes së përgjithshme në arsim, në radhë të parë, pas përfundimit të një viti shkollor apo akademik, pastaj në kohën kur nuk kemi presione, nënkupton – të mos bisedohet për arsimin vetëm kur kemi greva, kur kemi presione, por në kohën kur gjendja është paksa normale dhe tentojmë të bëjmë një zgjidhje adekuate. Natyrisht që ndikim në kërkesën tonë ka qenë edhe kërkesa e Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, por ajo kërkesë ka qenë e fokusuar kryesisht në çështjet financiare. Komisioni ynë ka menduar se pa injoruar, apo duke rrespektuar edhe kërkesën e tyre, është e nevojshme që të diskutohen edhe segmente tjera në fushën e arsimit. Mund të them se Komisioni pret nga kjo mbledhje apo nga kjo seancë e Kuvendit që të kemi një diskutim jo vetëm mbi vlerësimin e gjendjes ekzistuese në arsim, por kryesisht në dhënien e mendimeve, propozimeve të cilat do të kontribuonin dukshëm në përmirësimin e gjendjes.

Komisioni ynë ka pasur apo ka fokusuar 4 çështje kryesore, të cilat ka patur dëshirë t'i propozojë për bisedime. Fokusimi apo çështja e parë ka qenë krijimi apo, si të thuash, rrespektimi i bazës juridike në fushën e arsimit. Në radhë të parë kemi kërkuar që të rrespektohen në tërësi Ligji për arsimin fillor dhe të mesëm, e po ashtu edhe Ligji për arsimin e lartë. Këto kanë qenë dy arsye kryesore. E para ka qenë arsya, siç e dijmë, e zhagjitjes së nxjerrjes së këtyre ligjeve dhe tani kërkojmë që ato ligje të zbatohen sa më shpejt në praktikë dhe po ashtu edhe aktet tjera përcjellëse, por njëkohësisht ka qenë edhe një kërkesë jona që ligjet e nxjerra nga Kuvendi i Kosovës të zbatohen në tërë territorin e Kosovës. Pra, të jetë një unifikim në kuptimin juridik të sistemit arsimor.

Çështje tjetër, të cilën kemi menduar se mund ta diskutojmë dhe mund ta propozojmë për diskutim, është edhe çështja e procesit të reformave në sistemin tonë arsimor. Natyrisht që reformat si Komision i kemi përkrahur dhe i përkrahim edhe sot. Qëllimi ynë ka qenë që ato reforma të jenë të mbikëqyrura nga organet kompetente të evaulohen nga viti në vit dhe në fund kemi një reformë, si të thuash, që shkon në ujërat normale.

Ne jemi të vetëdijshëm që reformat janë diçka që e përjetojnë apo, si të thuash, bashkëjetojnë me sistemin arsimor gjatë tërë jetës së tij.

Si kërkesë e tretë, pa marrë parasysh prioritetet, ka qenë krijimi i kushteve për shpërblim adekuat të mësimitdhënësve. Ne kemi konstatuar se shpërblimi i punës së mësimitdhënësve, sotpërsot në Kosovë nuk është adekuat. Në këtë drejtim, nuk kemi dhënë ndonjë propozim konkret që do të thoshte 10, 15, ose 20%.

Ne kemi kërkuar nga Qeveria dhe kërkojmë edhe sot që të bëhet një projekt i cili do ta bëjë një zgjidhje adekuate dhe permanente. Ne mbështesim që mund të jenë zgjidhje për forma të ndryshme, por Komisioni mendon që zgjidhjet duhet të jenë në mënyrë permanente, së paku për një vit akademik. Njëkohësisht kërkon edhe nga sindikata dhe të tjerët që zgjidhjet të bëhen para fillimit të vitit të ri shkollor dhe jo gjatë fillimit të vitit apo gjatë punës, të kemi procese sikur në vitin e kaluar – protesta, greva ose forma të tjera. Ne, thash, nuk kemi dhënë propozim konkret, por kemi përkrahë format e participimeve që mund të bëhen në shkollim, kemi përkrahë formën e zhvendosjes së pjesës së buxhetit nga arsimit, një pjesë në pjesën tjetër apo edhe në tërësi nga buxheti i konsoliduar i Kosovës, duke tentuar që të rritet. Por, nga kjo, me siguri do të presim një projekt konkret nga Qeveria, i cili, me siguri, do të miratohet në Kuvend.

Dhe, fokusimi i katërtë, që mund të them është fokusim kryesor i Komisionit, por në tërësi edhe i sistemit arsimor është. Ne gjithë punën, gjithë aktivitetin, edhe të Komisionit, por edhe të Qeverisë, e të Ministrisë, e shohim në ngritjen e cilësisë së punës në arsim. Natyrisht, në këtë drejtim, shohim një angazhim më të madh të mësimdhënësve dhe të stafit administrativ, njëkohësisht shohim një angazhim më të madh në krijimin e kushteve për punën e tyre, por mund të themi edhe në përcjelljen apo në aktet përcjellëse qoftë për kushte, qoftë për aktet juridike, ose rrethanat tjera lehtësuese.

Këto katër qëllime, apo katër çështje që i kemi diskutuar, mund të themi se kemi ardhur edhe në disa rekomandime, të cilat i keni edhe ju, por për hirë të opinionit, sidomos për hirë të punëtorëve të arsimit, do t'i lexoj apo do t'i përfolja edhe para jush.

Në radhë të parë: Kemi kërkuar nga Qeveria, si rekomandim, që të hartojë strategjinë për zhvillimin e sistemit arsimor dhe ajo strategji të miratohet në Kuvend dhe në ndërkohë, duhet të jemi shumë fer, kemi marrë informata nga Ministria e Arsimit, të cilët kanë përgatitur një strategji të tillë. Ne përgëzojmë për punën, por kërkojmë që ajo strategji të vëhet për diskutim edhe në Kuvendin e Kosovës.

Rekomandimi i dytë është: Të unifikohet sistemi i arsimit në Kosovë dhe të hiqen paralelizmat. Ne të gjithë jemi dëshmitar që në Kosovë ende nuk kemi një sistem të unifikuar dhe kemi sisteme paralele. Kërkojmë nga organet implementuese, respektivisht nga Qeveria, që ta bëjë një gjë të tillë.

Angazhimi i tretë është: Qeveria të angazhohet për përmirësimin e gjendjes materiale dhe në afatin prej një muaji..., ne kemi menduar një muaj, edhe pse mund të jemi në pushim, të ofrojë një projekt dhe arsyeja është që para fillimit të vitit të ri akademik të dijmë gjendjen tonë, të dijmë mundësitë tona dhe fillimi të jetë i mbarë. Pra, të mosfillojmë një vit akademik me dilema!

Rekomandimi i katërtë është: Të nxirret ligji për veprimtari shkencore. Ne dijmë se kemi tash Ligjin për arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë, por ka nevojë që të kemi një ligj që stimulon apo rregullon edhe çështjet shkencore.

Rekomandimi i pestë: Të krijohen standardet bashkëkohore për vlerësim. Një konstatim të tillë mund ta gjeni edhe në rekomandimin, apo Raportin e punës së Ministrisë, por mendojmë se, në sistemin tonë arsimor, duhet të kemi një standard bashkëkohor mbi vlerësimin e dijes, mundit dhe angazhimeve tjera.

Kërkesa e gjashtë është: Të definohet pozita aktuale e instituteve ekzistuese dhe të stimulohen institutet e reja. Ne kemi shumë institute sot që veprojnë ose nuk veprojnë në Kosovë, të cilat kanë qenë të themeluara, por sotpërsot nuk dihet saktësisht qëndrimi i tyre, aktiviteti i tyre dhe mbi të gjitha pozita e tyre. Është mirë që kjo në një afat të caktuar të definohet – cila është pozita e tyre dhe në qoftë se kemi nevojë për institute shtesë, me siguri se ato duhet të stimulohen edhe nga Qeveria.

Si rekomandim i shtatë do të jetë: Qeveria të stimulojë bashkëpunimin e institucioneve tona arsimore dhe shkencore me institucionet ndërkombëtare. Në këtë kuptim, mendojmë se duhet të ketë projekte të veçanta, stimulim material sidomos, që institucionet tona përkrah punës së vet, të kenë edhe bashkëpunim të drejtë, korrekt edhe me institucionet tjera ndërkombëtare.

Rekomandimi i tetë është: Të bëhet profesionalizimi dhe profilizimi i shkollave të mesme. Besoj se kjo është një nevojë emergjente për tërë sistemin tonë arsimor, sidomos kur kemi parasysh se tani kemi mbi 18 mijë kërkesa për regjistrim në Universitetin e Prishtinës dhe kemi vetëm 5 mijë vende. Kjo nënkupton, në qoftë se kemi shkolla të profilizuara dhe të profesionalizuara shkolla të mesme, ata do të jenë të aftë për ekonominë e tregut dhe më pak do të gjenin rrugëzgjdhjen e tyre vetëm në Universitet.

Rekomandimi i nëntë është: Të vazhdohet me procesin e reformave në Universitet.

Rekomandimi i dhjetë është: Qeveria të bashkëpunojë me institucionet arsimore dhe shkencore dhe t'i angazhojë ekspertët për nevoja të veta. Unë mund të them dhe ndoshta ta marr një shembull, me siguri, sikur Qeveria të kishte angazhuar sot në ligjin paraparak që u diskutua ekspertë nga fusha e drejtësisë, pasi jam vet jurist, me siguri nuk do të kishim një ligj të tillë, të cilin ka nevojë që për çështje përmbajtësore por edhe teknike të kthehet... Por, njëkohësisht kjo nënkupton që është edhe një stimulim material edhe për ekspertët që punojnë në fushat e arsimit.

Rekomandimi i njëmbëdhjetë është: Qeveria të angazhohet vazhdimisht për shkollat tona apo për institucionet tona arsimore dhe shkencore të jenë laike dhe të depolitizuara. Mendoj se kjo çështje është paraparë jashtëzakonisht mirë me ligj, por mendoj se një veprim të tillë duhet ta bëjmë edhe në praktikë.

Rekomandimi i dymbëdhjetë është: Të bëhen propozime për ndërtimin e institucioneve të reja arsimore dhe shkencore, në kuptim të ndërtimit, të thuash, fizik apo objekteve dhe njëkohësisht për mirëmbajtjen e tyre. Natyrisht, për këtë kërkohet përkrahje edhe nga Kuvendi, do të thotë me siguri me buxhet shtesë, nga se kemi njohuri që nuk mjaftojnë objektet ekzistuese, shkolla fillore, të mesme apo edhe në Universitet.

Rekomandimi i trembëdhjetë është: Të bëhet një projekt i veçantë për stimulimin e kuadrove të reja dhe atyre ekzistuese. Në radhë të parë, mendojmë që ka vend dhe hapësirë për kuadra të reja, por gjendja mund të themi edhe materiale edhe tjetër nuk mjafton që të jenë shkollat tona ose Unviersiteti ynë të jetë atraktiv, me fjalë të tjera, dhe njëkohësisht kuadrove ekzistuese ekzistuese t'u jipet mundësia për, të thuash, ngritjen e tyre permanente.

Në propozimin e katrëmbëdhjetë: Është se besoj, aty pak është bërë një paksa lëshim. Është fjala që të krijohet këshilli nacional për reforma në sistemin arsimor. Çka kemi menduar me këtë këshill nacional, që emri është i diskutueshëm, mund t'ia ngjesim emrin

«Qendra», si t'ua merr mendja. Mendojmë se në Kosovë ka nevojë dhe ka mundësi që të jetë një këshill nacional, i cili do të ishte një organ mbikëqyrës për tërë sistemin arsimor mbi procesin e reformave, nga se ne, besojmë të gjithë, nuk e shohim të shkëputur që nga sistemi parashkollor e deri te Universiteti sistemin e reformave. Pra, të jetë një bashkëpunim, i cili kurrsesi nuk do të ishte organ paralel i Ministrisë, por do të ishte një organ i cili do t'i përcjellte që nga Kuvendi, që nga Ministria, që nga shkollat në mënyrë permanente reformat, sidomos evaluimin e tyre.

Nën rekomandimin pesëmbëdhjetë: Kemi paraparë të krijohet një fond nacional për përkrahjen e veprimtarive shkencore. Ne e dijmë, besoj, të gjithë se kemi raste kur njerëzit tanë dëshirojnë të merren me aktivitete shkencore jashtë ose brenda Kosovës, kanë ftesa njerëzit apo talentët e rinj për shkollim jashtë vendit. Mendoj se duhet të jetë një fond nacional, i cili duhet të përkrahet nga buxheti i Kosovës, por mund të ketë edhe donatorë vendor dhe të huaj, të cilët do të kishin në mënyrë permanente për qëllim përkrahjen e kuadrove, në radhë të parë do të nënkuptonte kuadrot deficitare dhe mendoj se kjo është punë jo shumë e rëndë që mund të bëhet, por do të lehtësonte punën e shumnjerezve tanë, por njëkohësisht do të përmirësonte edhe kushtet e atyre që dëshirojnë apo do t'u jipte mundësi njerëzve me talent.

Dhe, rekomandimi i gjashtëmbëdhjetë është: Të bëhen projekte që nxisin aftësitë konkurruese në arsim. Ne mendojmë se në arsim, përmbi të gjitha, mendoj ka nevojë të bëhen projekte konkrete e që nxisin aftësitë konkurruese në mes studentëve, në mes të nxënësve por edhe në mesin e vetë mësimdhënësve.

Mund të them se Komisioni vlerësimet e veta i ka dhënë jo mbi gjendjen ekzistuese, jo me ndonjë qëllim që të ketë iluzion se mund ta ndryshojë, por mbi të gjitha ka pasur parasysh kompetencat e veta që ka, kompetencat e Kuvendit dhe është i gatshëm që të japë sqarime plotësuese për secilin rekomandim. Beson se këto rekomandime do të plotësohen edhe nga ana juaj. Kërkon dhe beson se do të përkrahen nga ana e Kuvendit. Beson se Qeveria do të interesohet jetësisht për implementimin e tyre në praktikë dhe beson se bashkërisht do ta ndërtojmë një sistem arsimor çfarë edhe i ka hije Kosovës. Ju falemnderit për vëmendje.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Unë do të insistoj që, nëse kanë vullnet shefat e grupeve parlamentare, sepse mbi 20 diskutues janë paraqitur për debat, le ta marrin fjalën të parët dhe paraqitja e tyre do ta lehtësonte punën... Urdhëro zoti Hamiti.

SABRI HAMITI:

Zoti kryetar, zotni ministra, kolegë të çmuar,

Masi dëgjuam fjalën edhe të ministrit të arsimit, edhe konkluzionet faktikisht të Komisionit për arsim të Kuvendit tonë, ne pamë këtu një pëlqim gati total të pikëpamjeve, do të thosha unë dhe kjo më trimnon se kjo fushë me rëndësi të jashtëzakonshme për jetën në Kosovë dhe për të ardhmen e saj do të ketë konsideratën e vërtetë e dhe të shoqnisë. Dhe, vetë diskutimi në këtë nivel, në seancë plenare të Kuvendit, po them edhe një herë, na trimëron

sepse shoqnia në përgjithësi në Kosovë do t'i kthehet trajtimit fundamental të kësaj pjese të jetës sonë, e cila, për shumçka do të jetë determinuese në të ardhmen tonë.

Që në fillim, thash, se i shoh të barazvlefshme pikëpamjet e Ministrisë dhe të Komisionit të Kuvendit. Unë vetëm dua ta përgëzoj Ministrinë për një kujdes, do të thosha unë institucional të artikullimit të kulturuar të pikëpamjeve t'veta, të Raportit t'vet edhe të asaj, që ata e quajnë, strategji. Unë kam n'dorë këtu dy dokumente dhe kisha kërkuar që edhe ministrinë tjera të komunikoj në me ne në këtë nivel dhe në këtë formë. Dhe është mirë që nisët në këtë formë. Bile unë do ta bëja edhe një kompliment që, në kushte normale as s'do të duhej t'përmendej, por jemi lodhë me tekste të shkruara keq shqip dhe unë e kam një kompliment në këtë rast që janë të shkruara qart dhe sakt përgjithësisht, që është punë e mirë.

Domethënë, ne kemi punuar, sepse kam punuar në Komisionin për arsim, bashkë me grupet tjera dhe kemi ardhë në përfundimet që arsimit ka nevojë të mbështetet nga shoqëria jonë më s'pari masandej edhe nga institucionet kryesore, qysh është ky Kuvend yni, masandej Qeveria që është organ ekzekutiv, po edhe Presidenca, që mban kupolin e interesave të të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Mendoj që jemi në një fazë shumë interesante, po edhe shumdelikate për problemin e arsimit te ne, sepse, kemi kaluar fazën e rrezistencës për ekzistencë në arsimin për një dhjetëvjeçar, i cili ka prodhuar telashe të mëdha për njerëzit, njerëzit që kanë punuar edhe pa kompensime edhe janë lodhë, edhe janë harxhuar dhe tashi kalojmë në një fazë ku duhen të ndërtohen kriteret e vërteta dhe konkurenca e vërtetë. Gjithkjo kthesë është e rëndë, e dhimbshme dhe kërkon vullnet, po unë po ju uthem, kërkon edhe përkrahje shoqërore dhe para. Nuk ka mundësi që të përparohet sistemi i arsimit dhe të krijohen reforma të deklaruara me vullnet profesional dhe politik, qysh të doni, nëse nuk ka bazë materiale. E ne, sot, jemi në gjendjen që duhet të bisedojmë në atë elementaren dhe në njëfarë mënyre inisiativa bërthamore e kësaj mbledhjeje ka qenë puna e të ardhurave tepër të vogla të arsimtarëve. Po, keni kujdes, domethënë nuk është problemi i arsimit në Kosovë veç problemi i të ardhurave personale. Ky është sistemi i madh dhe ky nënkupton edhe financa shumë më të mëdha edhe kujdes shumë më të madh. Po, po nisemi nga fillestarja, domethënë ne kemi problemin e shpërbërimit të gjithë atyre punëtorëve që punojnë në shkollat që nga ato elementare deri te ato universitare dhe që shpërblehen, unë do të thosha, me shumica nën dinjëtetin e njeriut, me shumica, më vjen keq ta them nga foltorja po duhet të thuhet se janë poshtnuese për nivelet e punëve që kërkohen.

Është punë tjetër kontrolli i këtij mësimi, është punë tjetër diferencimi i punës dhe vlera. Dhe unë insisto, kjo është përmendur edhe te Raporti i Grupit por edhe te i Ministrisë, që në të gjitha nivelet të krijohet sistemi i vlerësimit, i diferencimit të vlerave. Çka nënkuptoj me këtë? Unë nënkuptoj me këtë jo vetëm në një nivel shkollimi po në të gjitha nivelet, bile ndoshta më së shumti, në Universitet. Dhe kujtojs e këto probleme përthyhen në mënyrën më dramatike në Universitet dhe ato që i kërkuam ne, në rekomandime, të cilat, menjëherë po ju them, i mbështes prej t'parit në të fundit është që të krijohen vlerat, mirëpo të përkrahen ligjet, por ju e dini sikur unë të gjithë se ekzistojnë ligjet dhe ekziston jeta. Dhe, nëse është hendeku i madh ligji i deklaruar dhe i jetës, ne s'jemi kërkund. Mjeshtria e shoqërisë është që t'i zbatojë ligjet me përpikni dhe jeta të ndërtohet sipas ligjeve të aprovuara. Çka dua të them? Nëse thomë se shkolla duhet të jetë e depolitizuar, ne duhet ta depolitizojmë. ... të jemi kreator të saj. Nëse themi se shkolla duhet të jetë laike, ne duhet të sillemi si njerëz që kërkojnë konkretisht shkollë laike. Nëse themi se duhet të kemi kriteret

për vlerësim, ne duhet të sillemi konform kësaj kërkesë dhe t'i valorizojmë profesorët e të gjitha niveleve, e unë prap po kthehem edhe në Universitet dhe të shohim çfarë, a i kanë ato vlera edhe a ta tituj që meritojnë dhe a kanë kaluar nëpër procedura. Se edhe procedura është pjesë e ligjit. Edhe, më e rëndësishmja, ndoshta.

Kështu që, unë nuk dua ta zgjas shumë. Unë mendoj se këto dokumente që kemi para, në kuptimin e formulimeve janë shumë t'mira, janë shumë t'sakta, mirëpo jeta duhet t'i bëjë të aplikueshme, dhe të aplikohen. Dhe, nëse aplikohen, duke marrë parasysh edhe një plan strategjik për zhvillimin e arsimit të Kosovës, që unë e kam lexuar me kujdes të madh dhe unë e pëlqej, po kjo sot s'është ashiqare në rend të ditës, unë pres që të marrim të gjithë përgjegjësitë, kujdesin, nivelin e barazimit të deklarimeve me veprimet dhe atëherë ne do të kemi shansë që ta sjellim arsimin në nivelin që na duhet, edhe në kuptimin e vlerësimit, edhe në kuptimin e realizimit të programeve. Po, të gjitha këto, nuk mund të bëhen!? Reformë, pa ndërrim të njerëzve, s'ka dhe pa pare s'ka! D'omethënë, duhen financa dhe duhen njerëz tjerë. Ju falemnderit.

KRYSUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Zoti, Arsim Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI:

I nderuari kryetar, të nderuar ministra, të nderuar kolegë,

Unë përkrah praktikën që jo vetëm sfera e arsimit por edhe sferat tjera të ekzekutivit të Kosovës të vijnë dhe raportojnë për gjendjen. Kjo nuk do të kuptohet si prezentim i raporteve, për shkak se Qeveria bën raporte në mënyrë periodike por si një diskutim për gjendjen e sferave tjera të ekzekutivit. Kështu që, mendoj se është një praktikë e mirë dhe propozoj të vazhdojmë me sferat tjera.

Mendoj se sot po diskutojmë një temë shumë të rëndësishme – gjendjen në arsimin kosovar, pra një fushë ndër më të rëndësishmet në jetën shoqërore në Kosovë. Përgjithësisht, arsimi, shkenca dhe teknologjia po përcjellin problemet e njëjta me të cilat po ballafaqohet Kosova në këtë periudhë të transicionit. Pra, edhe arsimi në Kosovë është në periudhë të transicionit nga një arsim ideologjik, nga një arsim i vjetër, me një përpjekje për të ndërtuar një arsim modern, me vlera qytetëruese. Dhe, në këtë drejtim, janë filluar shumë procese pozitive, të cilat nënkuptojnë që Kosova vërtetë të instalojë një sistem arsimor i cili do të prodhojë një rini të barabartë me vlerat çfarë merr edhe në botën qytetëruese.

Padyshim, hap i parë në reformimin e arsimit në Kosovë veç është bërë, për shkak se ne kemi të plotë kuadrin ligjor për sferën e arsimit. Pra, kemi dy ligje sistemore: Ligjin për arsimin e ulët e të mesëm dhe Ligjin për arsimin e lartë, që janë ndër ligjet më të mira, për shkak se janë hartuar me standarde më të larta ndërkombëtare, ndoshta edhe falë asistencës së fuqishme që kanë dhënë ekspertët e Këshillit të Evropës. Pra, në një mënyrë, ne kuadrin ligjor e kemi bërë dhe kemi trasuar rrugën për reformimin e arsimit në Kosovë. Por, tani ne duhet që me kritere profesionale, vërtet, të ndërtojmë një arsim çfarë i duhet Kosovës. Me këtë rast, gjithmonë duhet të kemi parasysh dy kritere: kriterin e vlerave qytetëruese të

standardizuara të arsimit që tani po koncipohen në nivel të Evropës dhe kriterin e veçorive të Kosovës. Nuk mundemi përnjëherë të kalojmë në një sistem pa pasë parasysh veçoritë të cilat po kalon Kosova. Kështu që, vetëm një kombinim i mirë i këtyre dy kriterëve do të sigurojë vërtet një reformim që do të jetë funksional në Kosovë.

Unë përkrah masat që janë marrë në arsimin e ulët dhe të mesëm dhe skemat e reja që janë përcaktuar dhe mendoj se kjo është një skemë, që tani është evropiane, por kërkoj që vërtet hapa të bëhen vetëm me kritere profesionale. Mua më vjen mirë që kanë filluar të punohen edhe strategjitë, që është shumë e rëndësishme, dhe me një transparencë të plotë dhe me një politikë të mirë të planifikuar.

Ajo që dua, në mënyrë të veçantë, tani të flas, është se dëshiroj të flas për gjendjen në arsimin e lartë. Ju e dini se në Kosovë vazhdon të funksionojë vetëm një institucion publik i arsimit të lartë – Universiteti i Prishtinës, që është themeluar nga Kuvendi i Kosovës. Ky institucion ka pasë jo vetëm vlera akademike arsimore, por ka patur edhe një vlerë çfarë të gjithë e dimë.

Mendoj se, duke qenë i vetmi institucion publik i arsimit të lartë, ky institucion po ballafaqohet me shumë probleme, që nga problemi që vërtet të jetë një universitet modern, me kritere moderne, deri te problemi që ai të bartë mbi vete edhe komponentën sociale - pra, t'i mundësojë sa më shumë qytetarëve të Kosovës, të realizojnë të drejtën kushtetuese që të marrin arsim të lartë. E përmendi kolegu Hajredin më herët që ne për çdo vit kemi nga 15 mijë njerëz që kërkojnë të drejtën e tyre për t'u shkolluar në arsimin e lartë. Kemi kapacitet vetëm për 5 mijë vetë për t'i përfshirë në këtë rrjedhë. Kështu që, ky problem është mjaft aktual dhe ka ardhur koha që edhe në frymën e ligjit, në frymën e Ligjit për arsimin e lartë, ne të hapim procesin e konkurrencës në institucionet e arsimit publik dhe të lejojmë sa më shumë universitete publike, kuptohet me kritere dhe me procedurë të akreditimit dhe licencimit siç parashihet edhe me Ligjin për arsimin e lartë.

Arsimi i lartë në Kosovë, tani është strukturuar në pikëpamje reformuese, karshi tendencave më të reja evropiane, pra në bazë të frymës së Deklaratës së Bolonjës, që është edhe fryma e Ligjit për arsimin e lartë.

Universiteti i Prishtinës, është ndër universitetet e para në rajon dhe në Evropën Juglindore që plotësisht është strukturuar në pikëpamje të këtyre skemave akademike. Ne për këtë edhe kemi marrë mjaft mirënjohje dhe me plotë përgjegjësi e them se, në krahasim me universitetet tjera të rajonit, të universiteteve të ish jugosllavisë, ne rangohemi ndër universitetet që më së larti ka shkuar në këto reforma. Por, natyrisht, ne kemi reformuar në pikëpamje teorike dhe ligjore mirë Universitetin, por nuk ia kemi arritur faktikisht ta reformojmë, duke patur parasysh se këto skema reformuese që janë evropiane, nuk janë përcjell me një tretman adekuat të shoqërisë, nuk janë përcjell me një kualitet, me një nivel të kualitetit çfarë na duhet dhe për këtë ka shumë faktorë. Kështu që, për momentin, mendoj se dy kemi sfidat kryesore në arsimin e lartë. E para, sigurimi i kualitetit dhe cilësisë që neve do të na bënte të barabartë, të pranueshëm dhe këto reforma që i kemi koncipuar vërtet të jenë efektive, pra të shtojmë kualitetin me masa shumë të planifikuara. Ne në Universitet kemi edhe strategjinë tani për shtimi në kualitetit, me një pako të masave që planifikojmë të ndërmarim. Dhe, e dyta, kriteri i dytë për këtë është tretmani adekuat shoqëror ndaj të punësuarve në arsim. Prej neve kërkohen reforma evropiane në kushte kur marrim paga feudale. Kërkohet që ne të japim një mësimdhënie kualitative, që t'i përkushtohemi plotësisht punës me studentë, në kohën kur nuk e kemi siguruar as

mbijetesën apo ekzistencën. Kështu që këto dy sfida janë tani sfida ndër më të rëndësishmet, me të cilat duhet të ballafaqohemi në periudhën e ardhshme, në mënyrë që vërtetë të sigurojmë një arsim të lartë.

Një tendencë tjetër është: ne dëshirojmë një arsim të lartë, të hapur për të gjithë qytetarët e Kosovës. Nuk dëshirojmë institucione arsimore të veçanta për shqiptarët, për serbët, për pakicat tjera. Dhe, siç dihet, Universiteti i Prishtinës për ashtu edhe është themeluar, pra si një institucion i të gjithë qytetarëve të Kosovës. Me kënaqësi mund të konstatoj se të gjitha pakicat janë të integruara në Universitetin e Prishtinës, me përjashtim të pakicës serbe, e cila, asnjëherë as që ka treguar dëshirë të sinqertë për të filluar procesin e integritimit. Ne kemi pranë Universitetit të Prishtinës Degën e gjuhës boshnjake, Degën e gjuhës turke. Sivjet po hapim edhe degë tjera. Jemi të gatshëm që këtë ta bëjmë edhe për pakicën serbe dhe kërkojmë që ajo të heqë dorë nga institucionet etnike, siç është universiteti i Mitrovicës dhe të fillojë të integrohet brenda Universitetit të Prishtinës.

Dhe, krejt në fund, një problem është e çfarë universiteti i duhet Kosovës. Ne dijmë praktikën e universiteteve të shteteve socialiste. E dijmë se shumë diktatura janë ngritur mbi kontrollin ndaj universitetit. E dijmë se në çfarë procesi të transicionit po kalojnë universitetet në krejt Evropën Juglindore. Universitetet, gjithnjë e më shumë, po marrin një karakter të ndërmarrjeve, të kompanive që punojnë me ligjet e ekonomisë së tregut. Unë, me kolegun Sejdiu, ishim për katër muaj në vëzhgim të reformimit të universiteteve amerikane dhe pamë se të gjitha universitetet shtetërore në Amerikë po kalojnë nga universitetet tipike shtetërore, të kontrolluara nga qeveria, në universitete moderne që fillojnë të krijojnë të ardhura dhe t'i menaxhojnë ato të ardhura. Për momentin, nuk e kemi këtë gjendje në Kosovë dhe për momentin Universiteti i Prishtinës plotësisht financohet nga Qeveria dhe mbyllet inisiativa dhe kreativiteti i njerëzve dhe në një mënyrë ngulfatet edhe puna shkencore, e cila, nuk merr stimulim. Ka ardhur koha që pakashum ta kemi një vizion se çfarë universiteti duhet dhe të fillojë të ndërrohet edhe metoda e menaxhimit të universitetit, në atë mënyrë që do të lejohet që krahas parave që marrim ne nga Qeveria, ne edhe vetë t'i krijojmë të ardhurat tona me projekte, me punë shkencore, me metoda të vetëfinancimit. Çdokund mësimdhënia është një mall që ka vlerën e vet. Në këto kushte, nuk e ka vlerën çfarë duhet dhe, ka ardhur koha, që ne të instalojmë një koncept modern të Universitetit, të ndryshëm nga universitetet socialiste, i cili do të krijojë një imazh shumë pozitiv jo vetëm për arsimin e lartë në Kosovë por, edhe Kosovën, në përgjithësi.

Unë mendoj, me këto masa që ka filluar t'i ndërmer edhe Ministria e Arsimit, por edhe me krejt procesin e reformave, ne jemi në rrugë të mirë që ndoshta për një kohë shumë të shkurtër ta përmbylim këtë proces të reformave dhe në një mënyrë të barazohemi me shtetet evropiane, në mënyrë që vërtetë rinisë tonë, për të cilën edhe kemi obligim t'i sigurojmë atë që e kemi edhe obligim, pra një dije jte pranuar, një dije me kritere profesionale, një dije të çmuar, e cila do t'iu bëjë të mundshme, jo vetëm të rinjve, por edhe kuadrove tona të lëvizin anëmbanë Evropës, pa pasë nevojë që të bëhet evaluimi dhe në një mënyrë akreditimi i njohurive të tyre. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Unë i lus diskutuesit tjerë... Katër referatet tjera ishin gjithpërfshirëse, prandaj, zoti Dugolli ka kërkuar fjalën, në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës dhe secili që është paraqitur për debat, le të analizojë a ka diçka të re që duhet propozuar apo jo. Urdhëroni...

BUJAR DUGOLLI:

T'falemnderit zoti kryetar, të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Aleancës, mbështet rekomandimet e Komisionit për arsim, që e dhe vetë personalisht jam anëtar i këtij Komisioni dhe kam marrë pjesë në hartimin e tyre.

Por nga ekspozeu i ministrit dhe nga të gjitha këto raporte që po na vijnë të shkruara dallon gjendja apo situata praktike në terren, me atë çka po i kemi si kërkesa apo angazhime. Shum nga ato që u thanë, nuk qëndrojnë, apo qëndrojnë në formën ndryshe në opinionin tonë dhe e dijmë se ndoshta është problemi më i madh apo lëmia më problematike që kemi tashpërtash dhe që ballafaqohet me halle dhe probleme më të mëdha.

Ne, nuk jemi të kënaqur si Grup Parlamentar të punojmë vetëm për zgjidhjen e çështjeve të tilla, në nivel të aspektit financiar të punonjësve të arsimit me infuzione apo metoda të përkohshme, por sygjerojmë Ministrinë që qetash të mendojë se kur të hartohen parametrat buxhetore për vitin e ardhshëm të insistojë me këmbëngulje që të rritet fondi apo buxheti për lëminë e arsimit dhe të mos vazhdojë në këtë mënyrë siç ka vazhduar, sepse ne e dijmë se çfarë patëm një gjendje kur miratuam buxhetin për këtë vit dhe më nuk duhet të lejojmë që buxhetin, parametrat buxhetore t'i hartojë dikush tjetër e ne të vijmë, të flasim një vit këtu kot, pa pasë mundësi të bëjmë ndryshime a ndërhyrje.

Një çështje tjetër që ne na shqetëson, është çështja e raporteve në mes institucioneve, në këtë rast Ministrisë dhe institucioneve arsimore, duke përfshirë Universitetin, sindikatat e tjera. Të gjithë jemi dëshmitarë se dëgjojmë shkrime të ndryshme nëpër gazeta, vlerësime nëpër opinione se këto raporte nuk janë në nivelin e duhur. Qeveria dhe Minsitria duhet ta dijë detyrën e vet, siç duhet t'i dijnë edhe institucionet arsimore, Universiteti apo sindikatat detyrat e tyre. Nuk duhet Qeveria të luaj, apo Minsitria të luaj rolin e tutorit dhe të përzierjes në autonominë e Universitetit. Unë dëgjova kolegun para meje që tha se: Kuvendi i Kosovës ka formuar në vitin 1970 Universitetin!? Po, kjo nuk do të thotë se Kuvendi i Kosovës, në këto rrethana të reja tash, në këtë demokraci që po instalohet në Kosovë, të përzihet dhe të ndërhyjë në punën e institucionit të shkollimit të lartë, në atë organizimin e tij të brendshëm, duke përfshirë edhe sistemin e financimit apo participimit të studentëve.

Unë personalisht, po ka të tillë shumë, që nuk janë të kënaqur, që qe një vit që është aplikuar metoda e participimit në Universitet, ku nga të hyrat e studentëve janë grumbulluar rreth 4,5 milion euro dhe ne nuk kemi një rezultat konkret se ku u investuan këto mjete, a përfitoi personeli mësimor, a përfituan studentët mjetet mësimore dhe ende nuk kemi një pasqyrë... Domethënë, këtu do të jipsha vërejtje për Ministrinë, në rend të parë, sepse është më përgjegjësja, normalisht edhe për Rektoratin, Universitetin dhe edhe Senatin e Universitetit, i cili merr disa vendime, ndryshe pas disa muajve, kthehet dhe merr një vendim ndryshe. Është çështja prap te regjistrimet, apo paraqitjeve të provimeve që i bëjnë studentët ku kërkohet që mos të detyrohen t'i aplikojnë, të paguajnë nëpër banga dhe më vonë kthehet dhe me një vendim të vetin prap e shfuqizon.

Në rast se dëshirojmë që institucionit publik t'ia dhëmë karakterin e vet si duhet, atëherë duhet të marrim shembull, institucionet publike të shkollimit të lartë, se si janë të ndërtuara

dhe të mos na mund lakmia e që tentojmë të vëmë kontroll dhe të bëjmë monopole politike, se edhe një pikë të veçantë thuhet që ta depolitizojmë, do të thotë se ka politizim në arsim. Kjo duhet të hiqet, duhet të hiqet se është në interesin tonë dhe nuk duhet të ndodhë që një ministër, tash nëse është nga radhët e LDK-ës të tentojë të vëjë monopol apo në të ardhmen, në vitet vijuese, të jetë një ministër nga radhët tjera. Thjesht, t'i dhëmë karakterin e institucionit publik dhe të mos përzihemi duke i ndaluar edhe tubimet politike apo promovuese qoftë të njerëzve të politikës, qoftë të njerëzve të partive nëpër objekte universitare, nëpër amfiteatra e tjera, e tjera.

Ne kërkojmë që të merren parasysh edhe kriteret që janë në Deklaratën e Bolonjës, edhe kriteret ndërkombëtare dhe mos t'ia mbyllim dyert Universitetit e të heqë dorë, apo ta rishikojmë edhe qëndrimin, edhe ndonjë vendim që kemi marrë më herët, në ligj, a ka nevojë me të vërtetë statuti i Universitetit të aprovohet në Kuvend. Unë mendoj se ky ka qenë një gabim dhe duhet ta evitojmë këtë gabim, ta lëmë Universitetin ta bëjë statutin, normalisht duke rrespektuar ligjin, dhe të mos ndërhyjmë në aspektin e grumbullimit të mjeteve që do ta bëjë Universiteti për t'i shti në punë në Universitet qoftë në kuadër mësimit, qoftë tek studentët.

Ne dëshirojmë që nga një arsye e shëndoshë dhe qëllimshme t'i japim këto vërejtje për këto që kemi evidentuar si parregullsi, me shpresë që edhe Ministria edhe Qeveria por edhe të gjitha grupet parlamentare do t'i kenë parasysh dhe ta ndërtojmë një sistem arsimor në nivel.

Po përsëris, rekomandimet i mbështesim dhe kërkojmë që këto të zbatohen në praktikë, mos të mbeten vetëm rekomandime në letër dhe ta marrim parasysh gjendjen në arsim e që mos t'na përsëritet fillimi i vitit me ndonjë problem apo edhe ndonjë kërkesë tjetër nga institucionet arsimore. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën Smilka Millosavljeviq, në emër të Grupit Parlamentar «Kthimi».

SMILJKA MILOSAVLJEVIĆ:

Poštovane kolege,

Prihvatiću sugestiju gospodina predsednika Skupštine, gospodina Dacija, da u svom izlaganju iznesem samo ono što dosada nije bilo predmet razmatranja i u vrlo kratkim crtama ću izneti stav Koalicije «Povratak» koji sam i zastupila na našoj Komisiji, obzirom da sam i ja član Komisije za nauku i obrazovanje a, osim toga, i aktivno sam učestvovala kao član Radne grupe u izradi ovoga Izveštaja.

Prema tome, obzirom da sam rekla da sam kao član Koalicije «Povratak» zastupila naše stavove, normalno je da sam te stavove i ugradila u ovaj Izveštaj, koji, Koalicija «Povratak», nema razloga da ne podrži. Znači, ona ga podržava, jer je apsurdno ne podržati napore da se podigne nivo standarda obrazovanja za sve zajednice koje ovde žive. Poboljšanje kvaliteta nastave, prihvatanje reforme obrazovnog procesa, to treba da bude svima nama prioritet i to ne treba da bude sporno.

Želim samo da dam neka pojašnjenja kada je u pitanju obrazovni proces za srpsku nacionalnu zajednicu. Kada je u pitanju visoko obrazovanje, mi imamo licencu za rad, u skladu sa autonomijom univerziteta a pristupamo reformi obrazovnog procesa u skladu sa Bolonjskom deklaracijom. To je znači što se tiče visokog obrazovanja. Što se tiče osnovnog i srednjeg, poznato vam je da smo u toku prošle godine dobili odobrenje od Specijalnog predstavnika Generalnog sekretara da sa reformom započnemo godinu dana kasnije i mi smo to ispoštovali i znači od jeseni počinjemo sa reformom u smislu devetogodišnjeg osnovnog obrazovanog procesa, u skladu sa međunarodnim priznatim standardima. Hala lepo.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Sadik Idrizi, në emër të Grupit Parlamentar...

SADIK IDRIZI:

...Par reči, u ime Grupe druge zajednice. Sistem obrazovanja je, mislim najobuhvatniji od svih sistema na Kosovu jer ne postoji porodica a da nije uključena u obrazovanje, ili je učenik, ili je nastavnik, ili je roditelj, znači to je jedna najkompleksnija i sa najviše problema. Mislim da Ministarstvo obrazovanja čini izuzetne napore da ova oblast stane na noge i suočena je sa ogromnim problemima. S jedne strane je problem materijalnog položaja, s druge strane reforma koja je neophodna i koja se traži i zahteva, s treće strane problem nerešenog kompletnog, znači, sistema obrazovanja kroz zakonodavstvo, mada je usvojen Zakon o osnovnom i srednjem, kao i Zakon o visokom obrazovanju a postoje problemi oko implementacije.

Što se tiče drugih zajednica, problemi su različiti od zajednice do zajednice. Ima zajednica koje obrazovanje stiču na albanskom jeziku, Aškalijske i druge i koje imaju problema oko upisa na fakultetu. Znači traže nešto dodatnih mesta da kao zajednica dobijaju, jer tamo jeste konkurencija, tamo jeste upis prema kriterijumima koje postoje, ali traže i zahtevaju da dobijaju određena mesta na fakultetima.

Romska zajednica je suočena sa problemom obrazovanja na svim nivoima i tu znači moraju dodatni naponi i od strane Ministarstva. Bio je pozvan predstavnik u ekspertskom timu i predstavnik Romske zajednice da bi se napravili prvi koraci i oko uvođenja nastave odnosno elemenata na ovom jeziku, odnosno za ovu zajednicu.

Što se tiče Turske zajednice, ona je mislim u boljoj situaciji od ostalih zajednica jer ima na svim nivoima, čije je osnovno, srednje i na fakultetu ovde u Prištini, kod ove zajednice je izražen problem dokumentacije na turskom jeziku u onim školama tamo gde se izvodi nastava na ovom jeziku, i mislim da Ministarstvo tu treba da uradi...(?) i dodatne probleme.

Prošle godine je u Peći otvoren i Fakultet za biznis na bosanskom jeziku. S jesenju očekujemo i fakultet za edukaciju u Prizrenu. Mislim da je tu od prilike stvar pri kraju i imamo tu podršku ministarstva i na bosanskom i na turskom jeziku.

Najveći problem jeste problem materijalne prirode sa kojima je suočena ogromna armija prosvetnih radnika na Kosovu. I daju se, čine se određene, da ne kažem inekcije prosvetnim radnicima koje nisu dovoljne. I ovo što je najavljeno 20% mislim da i to ima privremeni karakter i da to ne može da zadovolji prosvetne radnike.

S druge strane, već četiri godine nakon rata, nije napravljena nikakva nivelizacija, barem što se tiče u okviru škole, znači sistema, da li je to u okviru osnovnih škola, srednjih škola i na Univerzitetu. Mi imamo u osnovnim školama da je čovek sa 30 godina radnog iskustva i sa fakultetom – prima isti dohodak, koji prima radnik sa srednjom školom i koji je početnik. Mislim to mora jednom da se napravi i ta kategorizacija jer zaista barem mala razlika i da se stimuliše neko da ide dalje...

Drugo, ja ne vjerujem da je vezano za status Kosova, ili ne znam šta. Još naše škole nemaju svoje pečate. Da bi se jedan dokumenat, možda je to u gradskim sredinama drugačije, ali u seoskim sredinama udaljenim od 20-30 kilometara, potrebno je da se za jedan najobičniji dokumenat, za jednu potvrdu, za jedno svedočanstvo da se ide i do sada je to držao administrator UNMIK-a ili je zadužen za obrazovanje danas po opštinama. Nije to tu, tu može da se napravi na pečatu samo ime, naziv škole i u sredini jedna otvorena knjiga i da to bude dovoljno da je ta škola koja izdaje dokumenat. To su problemi dodatne poteškoće našim ... Mislim da te stvari moraju da se rešavaju da bi se olakšao rad u obrazovanju.

Ima problema ali ima i dosta rada. Ja sam bio uključen u jedan tim pri Ministarstvu i video sam kolike napore ulaže Ministarstvo sa svojim saradnicima. Hvala.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Fatmir Sejdiu si anëtar i Kryesisë. Le të bëhet gati Nimon Alimusa.

FATMIR SEJDIU:

Të falemnderit zoti kryetar, të nderuar deputetë, të nderuar ministra,

Unë do të përpiqem të jem i shkurt dhe dua të jap vetëm disa nga observimet e mia rreth përpjekjeve që po bëhen dhe duhet të bëhen më tej për një ecuri të suksesshme në fushën e arsimit, duke u përputhur plotësisht se kjo paralel është një nismë e mirë për atë model që, mendoj po ashtu edhe ministrinë tjera, secila nga fushat e veta, por besoj po ashtu edhe në kërkesë të deputetëve, të shtrojnë vizionin, ta quajmë, aktual dhe të strategjisë së mëtejshme që është i përputhshëm natyrisht me një program që ne kemi miratuar në Kuvend për punën e Qeverisë përgjithësisht në të gjitha sferat.

Ajo që do t'dua të konstatoj, është se intenca dhe qëllimi themelor yni si deputetë të Kuvendit dhe si Kuvend, mendoj edhe barrë e drejtpërdrejt e Qeverisë dhe Ministrisë gjegjëse, është: zbatimi i efektshëm i ligjit. Kur them këtë, me t'parën lirohem nga pjesët edhe të konstatimeve, edhe elaborimeve, edhe shumçka tjetër se në një mënyrë apo mënyrë tjetër është përfolje e asaj që është e precizuar qartë dhe që është pjesë e programit të Qeverisë, dhe natyrisht, është pjesë e programit edhe e Ministrisë konkrete, duke patur parasysh se mbi këtë bazë ka dhe janë të precizuara funksionet konkrete të secilit nga organet në bazë të asaj qysh ne jemi pajtuar këtu dhe kemi miratuar.

Çështja e dytë, është në procesin aktual. Ne gjendemi në një proces të reformave që ecën. Reforma që kërkojnë edhe energji, por që kërkojnë mbështetje materiale paralele shumë të fuqishme. Mbështetja materiale, që ka të bëjë vetëm me pjesën e pagave, është një segment, të themi, i nevojshëm dhe i domosdoshëm duke pasur dhe duke rikujtuar pikërisht qëndrimet tona të mëhershme në këtë Kuvend dhe kujtoj edhe në pjesën e Programit të Qeverisë për ngritjen e dinjitetit të arsimit, mësuesit, profesorit universitar.

Nuk mund të lejojmë, dhe këtë mendoj se Qeveria duhet ta ketë parasysh, që të shkojmë në veprime inercioni, në veprime kur, ta zëmë, Sindikata e Bashkuar apo dikush tjetër inicon pozicionin aktual material të punonjësve të arsimit dhe t'i jipet një inzheksion, siç tha kolegu më herët, për të kapërcyer gjendjen. S'mund të lejojmë, po ashtu, paralelisht dhe s'është në rregull që në paralajmërim për përmirësimin e pozitës del po ashtu paralajmërim tjetër paralel se është kjo e mundshme për këtë periudë apo për atë periudë. Kjo tregon joseriozitetin tonë në hulumtimin e çështjes, në hulumtimin e fondeve dhe të mundësiqe që duhet të mbështesin dhe në koordinimin e qëndrimit të një trupi qeveritar të përbashkët. Kjo ka ndodhë edhe në një fazë të mëhershme, por ndodh edhe tash.

Po ashtu, mendoj se, pikërisht në hartimin e kësaj strategjie, është pjesë e dokumentit, ta zëmë, të rekomandimeve që ka ofruar Komisioni parlamentar. Unë mendoj se, edhe në aspektin metodologjik, edhe si materie, rekomandimet janë të adresuara, jo vetëm në Qeverinë, janë të adresuara edhe në Kuvendin e Kosovës. Qeveria mund t'na ofrojë ligj, mund t'na ofrojë projekt dhe është Kuvendi ai që duhet ta bëjë. Të kërkojmë pikërisht në këtë masë konkrete të begatohet korpusi legjislativ, i cili ka të bëjë me këtë fushë sikur edhe me fushat e tjera.

Çështje tjetër është pikërisht te pjesa e mbështetjes materiale: është krijimi i fondeve të posaçme për dedikim. Janë disa nga ato që janë rekomanduar dhe pajtoj si deputet i këtij Kuvendi, por mendoj se Minsitria dhe Qeveria konkretisht mund të shkojnë paralel. Ju do të pyesni: - A do të ketë parë? Do të bëjmë përpjekje, bashkë: të krijohet edhe fond apo qendër stimuluese në kuptimin e rritjes së kuadrove, të studentëve dhe të nxënësve; të mos mbetet në pjesën e stihive të posaçme që, të themi, në pjesën e lëmoshës, që organizma, organizata joqeveritare, organizata ekonomike etj., etj., që kanë mundësinë dhe dëshirojnë ta bëjnë – të stimulojnë apo stipendojnë drejtpërdrejt, por të jetë edhe një pjesë e stimulimit të asaj kategorie që ne e quajmë - me shkathtësi të posaçme, apo talente të veçuar. Ne kemi raste që stipendimet e tilla apo bursime të tilla jipen edhe nga jashtë, dhe duhet t'i falënderojmë, por paralelisht të bëhet edhe brenda...

Dhe, një e fundit, depolitizimi në arsim. Mendoj se nuk e ka vetëm një vertikale. E ka edhe horizontalen e vet paralele. Nëse me depolitizim kërkohet, ta zëmë, mosimplikimi në ato pjesë të fushave të drejtpërdrejta që janë pjesë të kompetencave të përcaktuara edhe me ligj, edhe me, ta zëmë, akte të brendshme, po ashtu është njësoj, që fryma politike mos të bartet as në shkollën fillore, as në shkollën e mesme, as në Universitet. Kjo nënkupton lirimin e tërësishëm nga bagazhi i ngarkesave, apo nga ngarkesa politike për të kuptuar praktikisht se ajo pjesë atje mund të jetë pjesa që involvohet, ndoshta, edhe më drejtpërdrejt. Ju falemnderit.

(Seancën e krveson bashkëkrvesuesi Gojko Saviq)

BASHKËKRYESUESI GOJKO SAVIĆ:

Zahvaljujem se gospodinu Fatmiru i imamo još jednog člana Predsedništva koji je tražio reč, gospodin Bajram Kosumi. Izvolite.

BAJRAM KOSUMI:

I nderuari kryesues, të nderuar deputetë, të nderuar ministra.

Unë përshëndes punën e Komisionit për arsim, shkencë dhe teknologji që ka bërë edhe pse, unë personalisht, kam pritur që rekomandimet të jenë vërtetë rekomandime, e nuk janë të gjitha. Më tepër ka këtu politika parimore sesa rekomandime. Shikoni, për shembull, unë do të flas, ta zëmë për rekomandimin 5, 7, 10, 16, që janë parime shumë të përgjithshme politike, por nuk janë rekomandime çfarë është dashur të priten prej Komisionit.

Më lejoni që të them, edhe pse janë kështu, unë i përkrah këto rekomandime, por kam disa propozime që këtyre rekomandimeve t'u shtohen disa rekomandime të tjera.

Së pari, për procesin e përgjithshëm të reformave në arsimin në Kosovë. Mendoj se ky proces duhet të përcillet me debate publike të sferave që mirren me këtë çështje. Procesi i reformave është interes i dyanshëm. Aq sa është interes i pushtetit, i Qeverisë dhe i Ministrisë, është interes edhe i qytetarit. Prandaj, ky proces nuk mund të shkojë pa një debatim publik të tij.

Rekomandimi i dytë, ka të bëjë me programet mësimore, apo si u fol deri tash, dhe kryesisht u fol për depolitizimin e institucionit të shkollës. Por, unë propozoj që si rekomandim të jenë edhe depolitizimi dhe profesionalizimi i mësuesve të programeve mësimore, i librave dhe i të gjitha teksteve tjera që përdoren në institucionet shkollore.

Rekomandimi i tretë, ka të bëjë me hartimin e planprogrameve mësimore për shkollat fillore dhe të mesme. Duhet të formohet një këshill nacional, kurikular qysh po quhet, do të thotë një këshill nacional për hartimin e planprogrameve të cilin do ta themelojë Ministria dhe do ta miratojë propozimin e tyre Ministria, por nuk mund të mbetet në duar të zyrtarëve a të një ministrie fati i qindra-mijëra nxënësve: çka do të mësojnë në klasën e parë, të dytë, të tretë, të dhjetë e me radhë. Duhet të jetë një këshill nacional që bënë hartimin e këtyre planprogrameve dhe që pastaj Ministria miraton këtë propozim të tyre.

Rekomandimi tjetër ka të bëjë me klasën e nëntë. Unë nuk dua të lëshohem në konstatimin se çka është bërë me klasën e nëntë sivjet. Por e di se një numër i deputetëve, e në mesin e tyre kam qenë edhe unë këtu, kemi propozuar kur është miratuar ligji, që të miratohet ligji ashtu siç është, por klasa e nëntë të mos aplikohet këtë vit. Ministri ka dalë dhe ka garantuar këtu publikisht se janë bërë të gjitha përgatitjet e duhura që puna të shkojë mirë. Dhe, ato përgatitje të duhura, kanë rezultuar kështu: ka nxënës që udhëton 30 kilometra me shkue në klasën e nëntë. Dhe, klasa e nëntë duhet me pasë dhe, me thënë pak si në shaka – një traktor libra me veti, për ta kryer klasën e nëntë. Domethënë, në të gjitha lëndët

mësimore duhet nga 3-4 tekste t'i ketë me vete ai që do ta kryejë klasën e nëntë. Do të mungojë planprogrami, nuk ka për klasën e nëntë planprogram efikas.

Rekomandimi im do të ishte kështu: që të shfrytëzohet kjo verë, pavarësisht si ka shkuar ky vit, që viti i ardhshëm të jetë më ndryshe. Do të thotë në dy aspekte, një: të ketë planprograme të sakta, sikur që janë për klasën e shtatë, të tetë, e tjera, e tjera dhe dy: të hulumtohet mundësia që nxënësi të mos udhëtojë 30 kilometra me ardhë në klasën e nëntë. Në kushtet tona, s'ka kurrfarë kuptimi. Në Gjermani, ndoshta udhëton edhe 50 kilometra, por janë tjera kushte. Prej Mareci, me ardhë në Prishtinë, i bën 40 kilometra dhe kjo bëhet gjysma e rrugës këmbësh dhe gjysma me autobus. Kjo te ne, s'ka kuptim, do të thotë.

Rekomandimi tjetër, ka të bëjë me rrjetin e shkollave. Ka disa shkolla në Kosovë në të cilat, në një objekt shkollor, ta zëmë, janë paralelet e ndryshme, të gjimnazeve, të shkollave të bujqësisë, të shkollave ekonomike, e tjera, e tjera. Unë po përmend vetëm, ta zëmë, rastin e Vitisë, Shtimjes, të Rrahovecit e ndoshta, edhe diku tjetër ka. Do të thotë, kjo e pengon procesin e punës dhe Ministria duhet të hulumtojë mundësitë që të bëjë një rindarje të këtyre...

Këto ishin rekomandimet.

I kam edhe dy sygjerime, do të thotë, jashtë rekomandimeve, vetëm sygjerime për Ministrinë.

Sygjerimi i parë, ka të bëjë me financat. Unë besoj se Ministria, bashkë me Qeverinë, duhet të përgatisë një projekt, posfinancim nga buxheti. Një ide t'ia japë Kuvendit të Kosovës për financimin e shkollave, kryesisht shkollave të mesme. Mund të jetë një prej atyre ideve – pjesëmarrja në participimin e pagimit të shkollimit të mesëm. Shkollimi i mesëm nuk është i detyrueshëm. Nxënësit duhet të marrin pjesë, me çfarë përqindje është tjetërsend, por duhet të marrin pjesë në këtë fazë në financimin e shkollimit të vet. Kjo është detyrë e Ministrisë dhe Qeverisë të propozojnë dhe të mos mbetet fati i arsimtarëve vetëm çka të japë buxheti i Kosovës por të hulumtojë mundësitë çka mund të bëjnë në këtë drejtim.

Dhe, sygjerimi i dytë, ka të bëjë me arsimimin e lartë për qytetarët e Kosovës që gjuhën serbe e kanë gjuhë të nënës. Ky është problem tash në Kosovë. Ne e dijmë të gjithë atë problem, por nuk mund të luajmë rolin – ti fusim veshët në lesh dhe të presim çka po bën Beogradi dhe çka po bën Shtajneri. Këta qytetarë janë qytetarë tanë, janë qytetarë të Kosovës, e kanë problemin në arsimimin në gjuhën e tyre dhe Qeveria duhet të marrë nismën, të mos lejojë nismën e Beogradit dhe të Shtajnerit, por ministri i arsimit me Qeverinë, të marrë nismën e t'i propozojë Kuvendit çfarë zgjidhje mund t'u ofrojmë në këtyre studentëve. Ju falemnderit.

BASHKËKRYESUESI GOJKO SAVIĆ:

Hvala, gospodinu Kosumiju. Vi verovatno osećate da je u sali sve toplije i toplije, toplo ne u smislu diskusije, nego toplije jer zaista vidim da se ljudi rashlađuju. Mi imamo negde prijavljenih 17 diskutanata i ja bih, evo ovako iskreno, kao predsedavajući sada, zamolio da li neko želi da odustane od prijave ili da krenemo ovim redom kako su i prijavljivani kandidati.

Imate li predlog? Izvolite recite...

NIMON ALIMUSA:

Me radhë është dashur t'më jipet fjala, prandaj m'u murr fjala, hyri tjetërkush në radhë dhe kjo nuk përkon me normat...

BASHKËKRYESUESI GOJKO SAVIĆ:

Ne, ne. Ja se izvinjavam. Ja sam rekao da mi imamo određeni redosled i ja ću prozivati ljude po redosledu, tako da ja vas molim, ako nemate neki predlog, ja sam bio zaista ljudski ponudio predlog da se neko povuče, sednite na svoje mesto a ja ću prozivati onim redom.

NIMON ALIMUSA:

Zotni, në foltore jam thirrë me rend prej Nexhat Dacit, ju nuk ma dhat fjalën por ia dhatë tjetërkujt.

BASHKËKRYESUESI GOJKO SAVIĆ:

Ja se izvinjavam, možda sam ja... Izvolite.

NIMON ALIMUSA:

Zoti kryesues, të nderuar ministra, të nderuar kolegë,

Është bërë zakon që kushdo që del në këtë foltore të fillojë me një fjali – sot po trajtojmë një çështje të një rëndësie të jashtëzakonshme, të veçantë. Kjo është një klishe që po fillojmë vazhdimisht. Natyrisht se në këtë institucion, siç është Parlamenti, nuk diskutohen çështje të parëndësishme, por të gjitha janë të rëndësishme. Mirëpo, çështja e arsimit, unë do të thosha edhe e shëndetësisë dhe e policisë janë tri çështje që kudo në botë konsiderohen jo vetëm të një rëndësie të veçantë por konsiderohen si sektore të shenjta, si sfera të shenjta.

Unë do të shtroja që në fillim një pyetje dhe do të përgjigjesha se a e konsideron shoqëria jonë sferën e arsimit si të tillë. Nëse, në një shoqëri sikur kjo jona, ndahen vetëm 3.7% nga buxheti i përgjithshëm për sferën e arsimit, e ka vende ku kjo shkon deri në 13%, dhe nëse në një shoqëri, sikur kjo jona, punëtorët e arsimit pas orarit të mësimit vazhdojnë të mbajnë jetën duke u marrë me tregti të egër rrugëve, do t'na sjellë te konstatimi se: ne si shoqëri, nuk e konsiderojmë këtë sferë si të jashtëzakonshme, si sferë të një rëndësie të jashtëzakonshme dhe si një sferë të shenjtë.

Ne sot kemi për rend dite çështje të përgjithshme të arsimit. Andaj, do të ishte mirë që debati fillimisht të bëhet rreth raportit që ka paraqitur Minsitria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, të cilën ne e kemi qe shumkohë përpara. Unë do të ndalem pikërisht për këtë.

Natyrisht, jam anëtar i atij Komisioni për arsim, shkencë dhe teknologji dhe u përmbahem të gjitha atyre pikave duke përjashtuar një fjalë, atje diku, në pjesën hyrëse, ku thuhet “me negociata së bashku për disa çështje” e ju e dini se nuk është partner i këtyre çështjeve - së bashku me Qeverinë ose me Ministrinë, e tjera.

Që në fillim dua të sjell konstatimin, siç e sollën edhe disa para meje, se vërtetë ky është një Raport në kuptimin e plotë të fjalës – Raport i cili do t’ishite mirë të merrej si model edhe për ministrinë e tjera. Unë nuk e kam përjetuar veten të fyer me një dokument, siç ka ndodh shumëherë, duke u paraqitur llojlloj dokumentash para këtij Raporti.

Së dyti, unë dua të konstatoj se me faktet, me statistikat, me të dhënat e shumta që janë afruar në këtë raport, jam bindur se kjo Ministri ka arritur, duke udhëhequr një politikë profesioniste parimore, t’i realizojë me sukses shumicën e objektivave të paraqitura më parë. Dhe, objektivat i kemi si dukomunet. Ndonjë shkarje e vogël, siç ishte ajo nga seanca e kaluar, që mua m’u duk absurde se Ministria nuk ka reaguuar, sipas një gazete se një arsimtar paska konsumuar alkool, që me siguri nuk e zbehë punën e arsimit në përgjithësi dhe të Ministrisë në veçanti.

Meqenëse jam te ky Raport, unë do të bëja nja 3-4 pyetje.

Ndër qëllimet e kësaj Ministrie, në faqën 6, së pari, si qëllim kryesor, keni numëruar unifikimin e sistemit të arsimit në shkolla fillore dhe të mesme. Për fakultete e dijmë.

Pyetja: sa e keni arritur këtë unifikim?

Së dyti, në faqën 24, keni thënë: me kërkesën e Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe Teknologjisë, njësia e revizionit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë – A është duke bërë revizionin e financave në Universitetin e Prishtinës. Një pyetje e përafërt ishte edhe nga zoti Dugolli. Do të ishte mirë të na japni një raport, sepse është mirë të jemi sa më transparent rreth kësaj çështjeje.

Një pyetje tjetër. Kur keni përmendur pengesat, atje kah fundi diku, po edhe te objektivat, keni thënë dhe si pengesë keni numëruar – mosrrespektimin e ligjit dhe këtë ia keni referuar shkollimit të lartë. Të sqarohemi për këtë!

Dhe, së fundi, një çështje që e bëj nga terreni, është çështja e shkollave të mesme të mjekësisë, të cilat, me profesionet që kanë nxjerrë, janë konsumuar plotësisht, janë shkolla këto ku 90% janë femra, domethënë është interesi i gjinisë femrore – a ka mundësi të jetë vazhdimësia e kësaj shkolle, duke nxjerrë profile të reja që propozojnë ata, për shembull teknike – motër edukatore, teknike – sanitare ekologjike, teknik i kozmetikës e tjera.

Ndërkaq, sa i përket çështjes materiale të arsimtarëve, unë do të thoja se do të ishte turp i madh për atë shoqëri në të cilën pagesat e arsimtarëve zgjidhen vetëm me presione, me protesta dhe me ndërprerje të mësimin. Ju falemnderit.

BASHKËKRYESUESI GOJKO SAVIĆ:

Hvala, gospodine Nimon. Na redu je poslanik Drita Statovci, a neka se pripremi Sanije Alijaj.

DRITA STATOVCI:

E nderuara Kryesi, të nderuar ministër, kolege dhe kolegë parlamentar,

Është mirë që sot kemi marrë në shqyrtim një segment shoqëror, për të cilin jemi fort të interesuar që të gjithë. Mendoj ...(për momentin ndërpritet toni)...mendoj në arsimin në Kosovë që zhvillohet në të gjitha nivelet. Së pari i dedikohemi falënderimeve të posaçme për kryerjen e detyrës së arsimimit dhe të edukimit të brezave, madje si dje, ashtu edhe sot, veçmas për arsye se punoj me e pa kushte.

Plotësisht e vetëdijshme se pikërisht kushtet e arsimit dhe të mësimdhënësve të të gjitha niveleve meritojnë një debat të denjë, unë megjithatë, do të flas për diç tjetër.

Po e filloj me arsimin fillor dhe të mesëm. Në aspektin organizativ, të përfshirjes së njohurive dhe të dijes përgjithësisht, nëpërmjet lëndëve të caktuara arsimore, arsimit në Kosovë tanimë është përfshirë në reforma bashkëkohore, madje në arsimin e ulët, atë të mesëm dhe në atë të lartë. Dhe, kjo është një e arritur që na bënë të krahasueshëm me të tjerët në Evropë. Reforma është një dukuri që lë hapësirë për lëvizje, për ndryshime dhe avancime aty ku shfaqet nevoja. Jo rrallë, përvoja tregon preferencën për përshtatje dhe njohuri të reja. Në çdo shoqëri, në planprogramet mësimore të tyre projektohet njohja e trashëgimisë, njohja e identitetit kulturor përgjithësisht, njohja e kulturës njerëzore. Prandaj, shfaqet e preferueshme që në tekste të reja shkollore të shkollave të mesme dhe fillore, aty ku projektohet mësimi për shoqërinë, të gjendet vend edhe për një kaptinë të veçantë - për kulturën popullore dhe për trashëgiminë.

Çështja tjetër, që dua ta shtroj këtu, ka të bëjë me arsimin e lartë. Universiteti i Prishtinës, duke pasur për bazë autonominë dhe duke rrespektuar bazën ligjore, duhet të gjejë forma organizative të jetë gjithnjë e më i lidhur me ekonominë e vendit dhe në projektimin e kuadrove, por edhe të ndihmojë e sygjerojë për krijimin e institucioneve të reja, të nevojshme për shoqërinë tonë.

Universiteti i Prishtinës, ka hyrë në reforma dhe punon sipas reformave të reja. Brenda këtyre reformave, mund të bëhet edhe më shumë. Universiteti i Prishtinës ka bashkëpunim të mirë me universitetet kombëtare dhe ndërkombëtare, çfarë meriton lavdëratë.

Në këtë rrafsh, përvoja tregon preferencën që të shfrytëzohet më shumë dhe në mënyrë më të organizuar statusi i profesorit vizitor, si dhe mundësia e vazhdueshme e shkëmbimit të studentëve për të dëgjuar nga një semestër në universitete evropiane. Kjo preferencë vjen për arsye të krahasueshmërisë dhe të njohjes me të tjerët dhe të qëndrimit ballpërballë me të tjerët dhe ndërmjet të tjerëve.

Në vazhden e punës të natyrës së ngjashme, shfaqet edhe preferenca e komisioneve të përziera – Universiteti i Prishtinës – universitetet evropiane për mbrojtjen e magjistraturave dhe të doktoranturave, çfarë nuk është e panjohur për Universitetin e Prishtinës, por është e dëshirueshme që në këtë drejtim të ketë bashkëpunim më të madh. Po për arsye të cilësisë dhe të natyrës së nivelit të dijës e të përgatitjes së studentëve për punë të pavarur mësimore dhe shkencore, të hulumtohet mundësia e pjesëmarrjes së studentëve në sesione e simpoziume në nivel kombëtar e ndërkombëtar në cilësinë e vëzhguesit vetëm e vetëm që të asociohet me punë të natyrës së këtyllë.

Si çështje me vete, do ta shtroj këtu edhe bashkëpunimin në rrafshin Universiteti i Prishtinës – institucionet shkencore, brenda në Kosovë.

Kohët e fundit, institutet shkencore kanë mbetur disi në një pozitë të papërcaktuar çfarë nuk do të duhej të ndodhë. Organizimi brenda instituteve dhe mbështetja në kritere akademike, mendoj se lejon bashkëpunimin e dyanshëm pa ndonjë pengesë të madhe.

Dhe, deri tani ka patur bashkëpunim të konsideruar, por në këtë raport, lypset arritur edhe më tepër, të inicohen projekte të përbashkëta shkencore hulumtuese në terren ose në ambiente të mbyllura.

Po ashtu, për hirë të cilësisë e të njëjtësisë akademike, është e dëshirueshme të funksionojë mekanizmi që rregullon punën organizative dhe çështjen e gradave dhe të thirrjeve shkencore e profesionale në mënyrë që të mos ketë asnjë vështirësi për angazhimin e kuadrit të nevojshëm nga institutet në Universitet ose anasjelltas. Sidoqoftë, institutet nuk duhet lënë anash, sepse ato janë tonat, janë të s hoqërisë, veçanërisht në raste kur Kuvendi i Kosovës është edhe themelues i tyre.

Bashkëpunimi i Unviersitetit të Prishtinës me institucionet shkencore të fushave të ndryshme, mund dhe duhet të avancohet gjithnjë e më shumë. Kjo është edhe preferencë dhe imponim i kohës në të cilën po jetojmë. Ju falemnderit.

BASHKËKRYESUESI GOJKO SAVIĆ:

Hvala. Neka izvoli poslanik Sanije Alijaj, i neka se pripremi poslanik Halil Ahmeti.

SANIJE ALIJAJ:

Të nderuar kolegë, i nderuar ministër, i nderuar kryesues,

Pas leximit të Raportit të Ministrisë dhe pas leximit të propozimrekomandimeve nga ana e Komisionit parlamentar, krijohet një vizion i qartë për të arriturat dhe kthesat pozitive që janë bërë në sistemin e arsimit. Disa vizione të mia, me të cilat ballafaqohem në përditshmërinë e punës në arsim, do të bëj përpjekje t'i shtroj, por natyrisht se do ta thjeshtësoj shumicën e atyre vizioneve të mia për shkak se shumë çështje u shtruan nga parafolësit.

Zyrtarët ndërkombëtar, të cilët, pas vitit 99, erdhën në Kosovë, pas vizitave të para shkollore, kishin konstatuar se shkollat në Kosovë nuk janë sa duhet atraktive. Porosia e

tyre ishte: shkollat duhet të shndërrohen në ambient ku fëmijët mësojnë, aftësohen dhe argtohen.

Mjetet e shpenzuara katër viteve të fundit nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare për meremetimin e objekteve të dëmtuara dhe për shkolla të reja, bën të mundshme që të krijohen kushte relativisht të mira pune, por është e nevojshme që edhe të bëhet shumë për shkollën bashkëkohore.

Aprovimi i Ligjit për arsimin fillor dhe të mesëm, i Ligjit për arsimin e lartë, si dhe startimi për aplikimin e reformës në arsimin e Kosovës, konsideroj se janë dy të arritura të mëdha. Gjithësesi, këto dy çështje, që pasojnë me zhvillimet edhe të tjera, shkollës së Kosovës i hapin perspektivë mjaft a traktive dhe konkrete për lidhje dhe integritime në rrjedhat më bashkëkohore me shkollën moderne në botë. Shkollari i Kosovës do të trajtohet i njëjtë dhe i barabart me të gjitha vendet evropiane dhe do të ketë rrugë të hapura kudo.

Është e qartë se ecjet kaq të hovshme të vendeve të zhvilluara sot në botën bashkëkohore janë rezultat i arsimimit të tyre, vazhdimisht të reformuar, vazhdimisht praktik e pragmatikm, me hapjen e shtigjeve të reja të hulumtimit të problemeve nga gjitha fushat e mësimdhënies dhe mësimxënjes.

Mëse nuk jemi ne të kënaqur, atë çka duhet të bëjmë në të ardhmen e afërt si institucione dhe si shoqëri e Kosovës? Mungesa e hapësirës në shkollat tona, e lokalitë mësimor, infrastruktura e objekteve shkollore sidomos në qytet, është e pamjaftueshme për të plotësuar nevojat për punë normale. Disa shkolla punojnë në 3-4 ndërrime. Për ilustrim, në një shkollë të komunës së Ferizajit, në qytet, është, siç vlerësohet, shkolla më e madhe në Kosovë, me 3.759 nxënës, me sipërfaqe 1.852 metra katror e me 0,54 metra katror për krye nxënësi. Mungesat e teksteve shkollore, planprogramet adekuate me reformat dhe mjetet e konkretizimit dhe trajnimi gjithpërfshirës i arsimtarëve dhe të ardhurat e arsimtarëve shumë të ulëta, janë sfida, me të cilat duhet punuar shumë institucione tona. Konsideroj se do t'i kontribuonte mjaft arsimin nëse institucionet tona marrin këta hapa konkret.

Përcaktimi i Qeverisë për një rritje 20% në bazën mesatare 150 euro si intervenim i përkohshëm, nuk plotëson as përsëafërmi kriteret për një standard mesatar në arsim. Arsimtari, edhe më tutje, nuk ka motiv për punë cilësore dhe aftësim profesional për mësimdhënie. Ai, edhe më tutje, për të siguruar kafshatën e gojës për vete e familje, duhet të mirret me angazhime tjera, të cilat, jo vetëm që e ulin dinjëtetin e tij, por edhe e shkatërrojnë plotësisht fizikisht.

Si propozim tjetër, zbatimi i ligjit dhe mbikëqyrja e arsimin të bëhet në tërë territorin e Kosovës nga Ministria e Arsimin. Buxheti i arsimin të planifikohet në përputhje me nevojat e zhvillimit dhe kërkesat e reformës. Tekstet shkollore, lektura, planprogramet të hartohen dhe të sigurohen në përputhje me reformën e filluar në arsim. Arsimi i mesëm dhe arsimi i lartë të riprofilizohen dhe rishkallzohen në përputhje me nevojat e ekonomisë së vendit, e konkretisht me ekonominë e komunave. Këtë e them sepse tash startojmë me vitin dhe pranimin e nxënësve si studentë të ri në Universitetin e Prishtinës. Do të pranohet, pothuaj, një e treta e atyre që mbarojnë shkollën e mesme.

Në qoftë se si shoqëri dhe institucione, nuk do të ndërmarrim një hap, të gjithë a ta që mbarojnë shkollën e mesme, si rrugëzgjidhje do ta kenë largimin nga Kosova për të siguruar kafshatën e gojës. Kjo është një brengë që duhet ta brengosë edhe Kuvendin edhe

Qeverinë e Kosovës. Së paku duhet planifikuar dhe duhet të ndahen mjete nga buxheti i Kosovës që të hapen dhe universitete dhe fakultete tjera nëpër komuna tjera të Kosovës, natyrisht varësisht me zhvillimin ekonomik që ka ajo komunë, në mënyrë që mos të mbetet një numër aq i madh i nxënësve dhe të të rinjve tanë pa u përfshirë në shkollimin e lartë.

Të rritet shkalla e përgjegjësisë së institucioneve dhe shoqërisë në përgjithësi ndaj arsimit e sidomos ndaj arsimit të obligueshëm me ligj. Puna e mësimdhënësit të kompensohet në mënyrë adekuate, të merren hapa për zgjidhjen meritore dhe stabile e jo intervenim të kohpaskohshëm. Reformimi i shkollës është proces i vazhdueshëm, që është për të mirën tonë. Për këtë arsye duhet pasur qasje shumë serioze për të arritur atë që synojmë, për të ecur së bashku me sistemet e zhvilluara në botë. Ju falemnderit.

BASHKËKRYESUESI GOJKO SAVIĆ:

Hvala i vama. Reč ima Halil Ahmeti, neka se pripremi Salja Ahmetaj.

HALIL AHMETI:

Të nderuar deputetë, të nderuar ministra,

Unë do të ndalem vetëm në disa çështje të cilat nuk u përmendën deri më tani, që janë, mendoj edhe konkrete, por para se të filloj do ta përhëndes Ministrinë e Arsimit dhe ministrin Osmani dhe ta përgëzoj për punën që ka bërë dhe për Raportin që ka sjellë para nesh, për punën në procesin e reformave në të gjitha nivelet, kuptohet prej arsimit fillor, të mesëm dhe në Universitet, ngritjen e vazhdueshme të cilësisë në gjitha nivelet, pra duke pasur parasysh edhe kohën, pra Raportin njëvjeçar të punës.

Unë do të ndalem në tri çështje kryesore dhe atë: në sektorin e infrastrukturës, është faqe 32 e Raportit, 7.12, i cilli, si sektor është përgjegjës për vlerësimin e mjeteve dhe nevojave të hapësirës shkollore, planifikimit dhe koordinimit të projekteve si dhe realizimin e tyre, e sidomos një kujdes të veçantë t'u kushtohet viseve rurale. Është fjala për objekte shkollore të shkollave të mesme, duke patur parasysh kushtet e vështira ekonomike të një pjese të madhe të popullatës dhe shkollimin sidomos të vajzave nga fshati, pra të fshatrave të thella, larg qendrave të mëdha, si dhe duke patur parasysh shifrat e nxënësve, të vijimit të tyre, rezultatet e tyre në mësim në disa treva, me të cilat unë jam në kontakt të përhershëm dhe e njoh mirë situatën.

Nën dy, kam përfshirë sektorin e mbështetjes teknike 7.13, pra faqe 34 e Raportit, ku bëhet fjalë për njësinë e transportit. Në disa prej pikave, në Raport bëhet fjalë për sigurimin e transportit në rastin e mbajtjes së seminareve të punëtorëve... sipas kërkesave ditore, pastaj transportit për minoritetet, relacioni shtëpi-shkollë etj.

Unë mendoj se do të kishte vend këtu dhe do të potencoj të punohet për të gjetur forma që arsimtarëve të cilët udhëtojnë në relacione, domethënë çdo ditë nga qendrat në fshatra dhe anasjelltas, të mendohet që t'ju zgjidhet çështja e transportit apo ndonjë formë e kompensimit, duke patur parasysh të ardhurat që marrin arsimtarët dhe duke zbritur shumë që shpenzojnë gjatë muajit.

Dhe, nën tre, kam paraparë që tek zyra ligjore, pika 7.1, ku është përfshirë aty... dhe faktikisht unë kam shikuar në pikën 6, tek nxjerrja e udhëzimeve administrative për rregullimin e fushave të caktuara, por unë kam shikuar aty tek vizitat dhe ekskursionet e nxënësve të shkollave fillore dhe të shkollave të mesme, sidomos, me theks të veçantë. Këtu është fjala për përgjegjësinë e drejtorive komunale si dhe arsimtarëve kujdestar të klasave në organizimin e eskursioneve në Kosovë dhe jashtë Kosovës. Unë, në këtë rast e kam përcjellur edhe me fakte, nuk po dal ti theksoj ato, sepse jemi të gjithë dëshmitarë të organizimit dhe është kënaqësi e madhe, domethënë, të shohësh me dhjetëra autobus të rënditur njëpasnjë, por mendoj se edhe ministri në këtë drejtim diçka ka punuar, por mendoj se nuk është një kujdes i mjaftueshëm, domethënë një përgjegjësi e mjaftueshme e drejtorëve apo drejtorive të shkollave të mesme ose fillore, duke patur parasysh se, fatmirësisht këtë vit shkollor nuk kemi patur raste të aksidenteve të mëdha, fatmirësisht po them, por kjo mund të ndodhë nëse nuk kemi kujdes në këtë drejtim. Ju falemnderit, kaq pata.

KRYSUESI NEXHAT DACI:

Urdhëro pusho pak. Të falemnderit shumë Saviq. Sala Ahmetaj, le të përgatitet Edi Shukriu.

SALA AHMETAJ:

Përsëritës kryetarin e Kuvendit, ministrat dhe të gjithë të pranishmit, deputetët dhe të tjerët,

Unë nuk do t'i lexoj të gjitha që i kam shkruar, sepse shumë prej gjërave që desha t'i them, u diskutuan.

Shoqëria kosovare, domosdomërisht duhet të bëjë ndryshime në mënyrën e të menduarit dhe të të jetuarit. Por, për të ndryshuar shoqëria, duhet të ndryshojë sistemi i arsimit. Prandaj, edhe pse iluministe tingëllon domethënëse thënia pedagogjike «ndryshoje shkollën po deshe të ndryshosh shoqërinë». Midis shkollës dhe shoqërisë së një vendi duhet të sigurohet lidhje e fuqishme dhe kushtëzim i ndërsjell. Për t'u përmbushur këto synime tona në arsim, struktura ligjore tashmë ekziston. Por, Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Arsimit, tani do të duhej t'na sillnin për diskutim, në një afat sa më të shkurtër, strategjinë kombëtare për arsim. Plani kombëtar për arsim do t'i qartësonte, saktësonte përsosmërisht synimet tona. Ky plan kombëtar do të ndihmonte jetësimin e ligjit dhe do të ofronte projekte me përmbajtje të detajizuara, të afatizuara e të qartësuara në të cilat do të dihehin edhe bartësit e përgjegjësive. Qëllimet parësore të kësaj strategjie, sipas nesh, do të duhej të ishin, dhe do t'i them vetëm disa: puna përkushtuese për kultivimin e vetëdijes për shkollë kombëtare. Sepse, shqiptarët gjithandej dhe kosovarët veçanërisht, janë duke u ballafaquar me krizën e identitetit që tregon mungesën e dinjitetshmërisë e për pasojë ikjen nga identiteti. Kështu, parimi sintetizues dhe njësuës do të ndihmonin për t'i mundur faktorët ç'integruës si ndarja territoriale, administrative, mungesa e institucioneve unike kombëtare e tjera.

Kohëve të fundit, në emër të demokracisë dhe lirisë për shumësi idesh, shfaqen edhe pikëpamje që i mendonim të pakontestueshme, siç janë identiteti unik kombëtar dhe njëjtësia unike gjuhësore. Idetë e këtilla, pasqyrojnë një realitet të trazuar që lë të

nënkuptohet si një rrebelim i llastuar kundër normëzimeve. Por, pasojat mund të jetë tejet të dëmshme, sepse legjitimojnë projekte për copëzimin, pjesëzimin dhe fragmentarizimin e identitetit të njësuar kombëtar dhe gjuhësor. Në këtë çështje, plani nacional, do të bënte atë që s'e bën ligji, domethënë do të edukonte dhe do të ndërgjegjësojë.

Pastaj, një pikë tjetër. Dysia është veçori e çdo universiteti. Universiteti është institucion edhe arsimor, edhe hulumtues-shkencor. Prandja, akademizmi duhet të ruhet, të mbrohet dhe të jetë synim dhe qëllim edhe i Universitetit tonë.

Megjithë kriteret për standardizim me universitetet e Evropës, universitet unik evropian nuk ka. Por, secilli universitet ka veçoritë dhe specifikat e shtetit të vet, sepse ai së pari është themeluar për kërkesat e shoqërisë dhe vendit të tij.

Dhe, një pikë tjetër. Ne do të duhej të tentonim të largonim ndjenjën e inferioritetit dhe të paragjyqimit se a ta që studiojnë në Prishtinë s'mund të krahasohen me të tjerët. Këtë e përgënjështrojnë faktet, sepse vlera dhe antivlera, ka kudo në botë. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Ju lutem, të tjerët t'i përmbahen kohës dhe mbi të gjitha, ju po shihni në çfarë rrethana fizike funksionon Parlamenti. Në qoftë se nuk ka freski në propozime, diagnoza është thënë shummirë nga shumë diskutues. Prandaj, ata që nuk kanë ndonjë gjë të re, nuk është keq edhe të abstenojnë derisa t'i përmirësojmë kushtet fizike, pas adaptimit. Edë Shukriu, le të përgatitet Sabile Basha.

EDI SHUKRIU:

Ju falemnderit. Nuk mund të flas nga kjo foltore pa shpreh edhe admirimin tim të thell për të gjithë mësimdhënësit të të gjitha niveleve. Dua të përkujtoj se, së bashku me minatorët, mendoj se mësimdhënësit janë shtresa më e merituar e shoqërisë sonë dhe mjerisht më e harruar. Këtë çka po flasim sot, mendoj është dashur ta bëjmë qëmoti e mbase ka qenë data e fundit që sot të flasim për ato kërkesa konkrete të mësimdhënësve. Është çështje ekzistenciale e tyre.

Dëgjova parafolësit, dëgjova ministrin e tjerët. Dhe, më besoni, krijova bindjen se çdo gjë është në rregull. Po, mrekulli qenka! Strategjia qenka përgatitur, Raporti i mrekullueshëm, e tjera, e tjera. Dhe, pyeta veten – athua, pse si mësimdhënëse hidhërohem çdo ditë? E besoj, këtë ndjenjë e kanë edhe të gjithë mësimdhënësit e tjerë. Mendoj se, pos fjalëve të bukura dhe letrave të mira, madje edhe të shkruara me një gjuhë të lakmuar letrare, duhet të nisim implementimin e gjërave.

Mbase e them fjalën e rëndë se mund të jemi para një kolapsi në arsim dhe mendoj se këtë kolaps në arsim e parandalon vetëm ndërgjegjja, ndërgjegjja shumë e lartë e mësimdhënësve tanë. Për ta, prioritet gjithmonë ka qenë nxënësi dhe studenti. Natyrisht se arsimi dhe shoqëria demokratike në përgjithësi nuk mund të zhvillohet vetëm në baza të ndërgjegjes së mësimdhënësve dhe vullnetit të tyre për të edukuar gjenerata. Për këtë është e nevojshme, natyrisht, mbështetja institucionale dhe atë një mbështetje e vërtetë dhe e pakursyer dhe urgjente, e shpejtë, e pavonuar. Dhe, mendoj mbi të gjitha, nga ky Parlament, i cili duhet t'i

bëjë presionet e nevojshme. Sfidat, me të cilat ballafaqohen punonjësit e arsimit janë bërë, mendoj, dhe e di, jam shumë e bindur se pajtoheni me mua, të patejkalueshme. Pikësëpari duke u nisur nga gjendja tejet e mjerueshme materiale e tyre, e edukuesve të fëmijëve tanë para syve të të cilëve ngriten pallate private, para syve të të cilëve bëhen manifestime luksoze me mjete shumë të mëdha dhe në të cilat, mjerisht, ata nuk kanë mundësi të marrin pjesë. Madje – madje, mund të them, po gjenden mjete të hatashme përdo manifestime qofshin edhe të nivelit shumë të lartë, nuk dij prej nga, po bëhen suficite e nuk po gjenden forma që të rriten pagat e arsimtarëve.

Shfrytëzoj rastin të përkujtoj edhe për pozitën e mësimitdhënësve pensionist, dinjëtetit i të cilëve vërtet është shkelur tmerrësisht.

Propozoj që Qeveria të ketë parasysh, domethënë, edhe këtë shtresë të ish punonjësve të arsimit.

Natyrisht se më duhet ta shtroj pyetjen – si të realizohen reformat edhe ashtu, sipas bindjes time, pakashum kaotike, do të thotë shumë të qarta, në një situatë të tillë të krijuar.

Mendoj se Parlamenti se, sa duhet të krijojë dhe avancojë bazën ligjore, një punë të madhe kemi bërë në ndërkohë, aq duhet vëmendje t'i kushtojë, dhe ta bëjë, kontrollin e implementimit të tyre. Natyrisht kjo pamundëson ndikimet partiake, mundëson depolitizimin e nevojshëm të sistemit arsimor dhe ne duhet ta pranojmë se politizimi i arsimit deri në nivelin universitar ekziston. Jemi të vetëdijshëm, prandaj edhe qartë duhet të flasim për këtë dhe të gjejmë bashkërisht forma si të tejkalohen.

Mendoj se në këto forma hapen rrugët për potencial kualitativ arsimor dhe shkencor kosovar, për të cilin mendoj se ka por i mbyllën dyert.

Dua të potencoj se mbështetja e arsimit, kur kihet parasysh numri i madh i mësimitdhënësve femra, njëkohësisht ndikon dukshëm edhe në mëtimet tona për barazinë gjinore që është po ashtu një prej parakushteve të shoqërisë sonë.

Në fund, duke mbështetur kërkesat e mësimitdhënësve, dhe rekomandimet e Komisionit, për të cilat mendoj se është dashur do të thotë të jenë më konkrete, më duhet të them se ruajtja e dinjëtetit të mësimitdhënësit është po ashtu ruajtje e dinjëtetit të Kosovës, dhe avancimi i tij është avancimi demokratik i Kosovës dhe të gjithë qytetarëve të cilët jetojnë në Kosovë. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderi shumë. Sabile Basha, le të bëhet gati Ramadan Kelmendi. Ju lutem, konceptone diskutimin brenda kohës së lejuar.

SABILE BASHA:

I nderuar zoti kryetar, deputetë të nderuar, të nderuar ministra,

Megjithatë, do të filloja se është fort e qëlluar pika e rendit të ditës që bën fjalë për gjendjen në arsimin kosovar. Por, do të shtoja se, krahas kësaj çështjeje, do të ishte me interes që të diskutohet edhe për gjendjen e institucioneve shkencore dhe të veprimtarisë shkencore. Sepse, çdo shoqëri me pretendime bashkëkohore, në aktualitetin e vet, i kushton vëmendje të veçantë përkrahjes dhe zhvillimit të institucioneve shkencore, se pa një progres të mirëfilltë të shkencës, nuk ka as përparim të shtetit e as të shoqërisë në përgjithësi.

Pasi jam punonjëse shkencore e Institutit të Historisë në Prishtinë, vëmendjen tuaj do të dëshiroja ta përqëndroj rreth këtij institucioni dhe institucioneve të tjera shkencore.

Është e mirënjohur edhe koha e formimit por edhe e rritës së vështirë, me plotë pengesa dhe sakrifica që bënë institucionet tona gjatë rrugëtimit të tyre. Instituti i Historisë, së bashku me institucionet tjera shkencore i sfidoi ato duke dhënë kontributin e vet shkencor, ashtu siç mundi e diji, brenda kushteve të pakushte. U realizuan dhe botuan një numër i konsideruar monografishë, revistash shkencore, u mbajtën simpoziume, konferenca e tryeza shkencore, kuptohet nëpër shtëpi e lokale private. Andaj, më duket se ka ardhur koha kur edhe ne, si shoqëri e organizuar, me premisa të një jete plurale demokratike do të duhej një qasje më me përgjegjësi ndaj këtyre institucioneve, të cilat i kemi në mënyrë që ato të hetojnë përkujdesjen e Parlamentit, të Qeverisë, të Ministrisë dhe të shoqërisë sonë në përgjithësi. E tani mendoj se Instituti i Historisë dhe institucionet tjera shkencore duhet të trajtohen në mënyrë më të denjë, ashtu siç i trajtojnë vlerat e veta edhe institucionet me rëndësi kombëtare në çdo vend në rajon dhe në botën e qytetëruar.

Jam plotësisht e bindur se tani kur po trajtojmë gjendjen në arsimin kosovar, kujdesi i institucioneve tona do të duhej të jetë në nivelin e duhur në të gjitha aspektet e mundshme, sepse shpresojmë se pas gjithë asaj që kaloi Kosova është e domosdoshme që Instituti i Historisë dhe institutet tjera shkencore, të luajnë rolin që iu takon në shoqërinë kosovare. Investimi i një kujdesi të veçantë shoqëror, aty ku është vendi, do të jetë i mirëpritur aq më tepër kur dihet se Kosova ka një histori të lashtë, të begatë e dramatike, siç u dëshmuua me luftën e UÇK-ës dhe intervenimin e NATO-s më 1999. Andaj, meriton t'u kushtohet një qasje më serioze studiuesve dhe institucioneve shkencore. Është mirë që të investohet në shkencë e sidomos në shkencat e historisë, me të vetmin qëllim që të kemi një histori të mirëfilltë ngase nuk thuhet kot se ata që harrojnë të kaluarën janë të dënuar ta përsërisin.

Shpresoj se do të gjendet mirëkuptimi i institucioneve tona që brenda mundësvie që ka Kosova, të përkrahin Institutin e Historisë, i cili po bën përpjekje maksimale për t'u reformuar, përtërirë dhe për t'u marrë me projekte serioze e shkencore. Fatkeqësisht ky Institut përballet me një varg problemesh të vjetra dhe të reja, të cilat e pengojnë zhvillimin, konsolidimin dhe përparimin e tij. Pokështu do të duhej përkrahur edhe Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Institutin Albanologjik, atë Ekonomik dhe institucionet tjera shkencore.

Deputetë të nderuar, Instituti i Historisë, është i vetmi institucion i rangut kombëtar në Kosovë që nuk ka objekt të vetin, ku do të mund të zhvillonte veprimtarinë themelore por që ka lejen e organeve kompetente për të ngritur një godinë në Qendrën Universitare, e cila

padryshim, do të jetë edhe një shansë më tepër për konsolidimin, organizimin dhe freskimin e jetës shkencore institucionale tek ne.

Ne do të duhej të angazhohemi për përkrahjen e orientimeve programore me synim të zhvillimit e të përparimit të mendimit shkencor si faktor dominant i perspektivës së Kosovës. Po ashtu e konsiderojmë me rëndësi e vlerë të posaçme përkrahjen morale e materiale të Parlamentit të Kosovës si themelues i këtij Instituti me rëndësi kombëtare dhe shtetërore.

Dhe, krejt në fund, do të kisha lutur ministrin Osmani, brenda mundësive që ka, të na përgjigjet - se deri ku është arritur me realizimin e projektit të objektit të Institutit të Hisotrisë. Ju falemnderit për vëmendje.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Në demokraci ka edhe abstenime! Ramadan Kelmendi, le të përgatitet Shefki Sejdiu.

RAMADAN KELMENDI:

I nderuar kryetar, të nderuar ministra dhe deputetë,

Unë do të heq dorë nga një pjesë e diskutimit tim, pasi që po përsëriten, por kam propozime konkrete.

E para. Mendoj se në Kuvend vijnë për t'u shqyrtuar çështjet në mënyrën më kualitative dhe përmbajtësore dhe vërtet koha shpeshherë nuk po lejon këtë dhe kërkesat, shpeshherë, janë të paarsyeshme.

E dyta. Mendoj se edhe nga deputetët mund të kemi vlerësime reale dhe shumpërmbajtësore, e jo vetëm nga anëtarët e Kryesisë.

Dhe, e treta. Anëtarët e Kryesisë, vlerësimet e tyre duhet më tepër t'i shqyrtojnë në Kryesi, e më pak këtu.

Unë mendoj dhe përgëzoj ministrin e arsimit që ka përgatitur Raportin e punës për një periudhë të caktuar, e këtë do të ishte mirë ta bëjnë edhe ministritë tjera dhe ministrat.

Këto tjerat që i them, nuk kanë të bëjnë me ato të përsëritura. Pagat e punëtorëve në arsim, është mëse e nevojshme të nivelizohen në raport me përgatitjet shkollore me profesionet tjera. Pra, këto duhet të jenë në harmoni me pagat që paguhen në administratë, gjyqësi e tjera.

Së dyti. Ne kemi, arsye shumë të madhe të diskutojmë dhe mendojmë për arsimin dhe për gjeneratat e reja, të cilët dëshirojnë të shkollohen e arsimohen, t'u ikën rrugëve, drogave, kafeve e tjera dhe mos ta rrisim problemin e papunësisë. Në vit, hyn kontingjenti prej 22 mijë të rinjve që nuk mund të regjistrohen në fakultet dhe ata janë potencial për papunësi dhe për të gjitha elementet tjera.

Së treti. Mendoj se Ministria e Arsimit dhe Rektorati, duhet të mendojnë për unifikimin e procedurave dhe vlerësimin e temave për marrjen e gradave shkencore duke u mbështetur në kriteret shkencore dhe procedurat e përcaktuara paraprakisht.

Hapësira e Universitetit të Kosovës, gjegjësisht të Prishtinës, të lirohet nga objektet e kultit e fetare dhe si e tillë ajo të ketë tretmanin që duhet ta ketë sikur çdokund në botë.

Mendoj se Ministria e Arsimit dhe Rektorati i Universitetit, duhet të bëjnë përpjekje më maksimale që Fakultetin Xehetaro Metalurgjik në Mitrovicë ta kthejnë në lokale të veta, aty ku e ka vendin dhe ku duhet ta kryejë misionin e vet.

Planprogramet e arsimit të jenë unike si dhe të eliminohet në procesin e arsimit paralelizmi i drejtorive të arsimit dhe i zyrtarëve të lartë të arsimit.

Dhe, po e përfundoj, vërtet planprogramet duhet të jenë unike, sepse në qytetin, nga vij unë, në dy anët e lumit, në njërën anë flitet dhe mësohet për faktorin ndërkombëtar si çlirues, ndërsa në pjesën tjetër si okupes.

Vlerësoj se rekomandimet e Komisionit për arsim duhet të plotësohen edhe me këto propozime dhe i përkrahu si të tilla. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shum. Zoti Shefki Sejdiu, le të bëhet gati Fatmir Rexhepi. Bëru xhentëlmen dhe ia lësho rendin Edita Tahirit, Fatmir. Edita Tahiri, le të bëhet gati!?

SHEFKI SEJDIU:

Zonja dhe zotërinj, deputetë e ministra,

Hezitova të diskutoj, por dikushi ndoshta do të kishte shtruar pyetje - athua pse heshti. Po them – pse heshti, sepse i kam përcjellur dyzetedy gjenerata nxënësish dhe studentësh.

Unë nuk dua të përsëritem. Do ta shof të nevojshme ta kemi të qartë. Ne si deputetë, edhe opinioni, shoqëria në përgjithësi ta kemi të qartë konceptin mësues, konceptin nxënës dhe konceptin në arsim. Po më duket se bredhemi ne këtu kur flasim për shkollën, kur flasim për reformën e të tjera.

Të gjithë u pajtuam se arsimi është një veprimtari me rëndësi të veçantë, pajtohemi. Nuk mjafton kjo, shoqëria duhet ta sigurojë funksionimin e arsimit përmes rrugëve më efikase. Mësuesi është një permanencë relativisht statike, në raport me nxënësin e studentin, që është tepër dinamike. Kur t'i kuptojmë këto dy raporte, do të jemi në gjendje të japim vlerësim real edhe për veprime të tjera, siç është, për shembull, reforma.

Mësuesi gjendet në mes traditës dhe reformatores. Përsëri qëndron te tradita. Edhe shkollat, metodologjitë më radikale evropiane e botërore mendojnë se mësuesi, megjithatë, mbetet

në klasë, se mësuesi amerikan, megjithatë i ngjanë shumë mësuesit të shekullit 19 dhe 20, amerikan aktual. Prandaj, kemi shumë kujdes. Ka shumë thirrje për transformimin e mësuesit. Mësuesi është i detyruar të përcjellë zhvillimet dhe natyrisht në zhvillim, në hap, dhe ai duhet të ndërrojë, por jo aq sa mendohet. Sepse, mësuesi është ai që gjendet, pra, në mes të asaj tradicionales dhe transformueses, që lidhë parimoren në përgjithësi - teoriken me realitetin. Këtu duhet të kemi kujdes gjithashtu dhe është realizues dhe bartës kryesor i ndryshimeve. Kur të them bartësi kryesor, do të thotë se shoqëria duhet t'i kushtoj kujdes të veçantë m'u mësuesit dhe kësaj veprimtarie. Kur po them mësuesin po them mësimdhënësi, arsimtari e të gjithë këta.

Dhe, të mos teoretizoj shumë, edhe një gjë po ju them se është imanente te mësuesi: - mësuesi është një individ rregullisht i stresuar. Prandaj, shoqëria duhet ta ketë kujdes këtë element. Ky është imanente profesionale. Mësuesi është një personalitet shumëkompleks, pse ai është edhe pedagog, edhe psikolog, edhe edukator, është edhe mjek në një mënyrë, gjykatës e mos të them, të shkoj te polici e tjerë të gjitha këto.

Prandaj, që puna jonë, reformimet tona të jenë efikase, duhet t'i kemi të qarta disa gjëra. Të qarta në aspektin sistemor dhe konceptual të punës sonë në arsim, aspektin metodologjik dhe teorik, që duhet shoqëria t'i sigurojë në arsim. Duhet të kemi kujdes te aspekti moral. Këtu vjen edhe vullneti, dëshira për punë, për përparim dhe disa probleme, streset që thash: mësuesi ynë është posaçërisht i shtresuar sepse dhjetëvite ka punuar në kushte aspak normale dhe ato pasoja shifen, edhe nxënësi gjithashtu i bart ato pasoja. Material, u disutua, infrastrukturor gjithashtu, dhe aspekti që arsimit të funksionojë si duhet, të kemi kujdes u tha këtu, por po e them dhe përsëris, vetëm profesional, administrativ e tjerë.

Dhe, po e përfundoj me gjysmë minuti. Diogjeni i famshëm spirituoz porositi: Themeli i shtetit është rinia. Keni kujdes! Dantoni thotë: Pas buke është menjëherë, për një shoqëri, edukata më e nevojshme. E Derek Boku, thotë: Nëse mendoni se arsimit është i shtrenjt, provojeni paditurinë. Atëherë do të bindeni se arsimit nuk është i shtrenjt. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Ishte rrespekti për kohë të dyfishtë të lejuar, prandaj Edita do ta ketë fjalën. Kam një propozim, kemi edhe pika tjera të rendit të ditës dhe kemi aprovimin e rekomandimeve. Ose ta reduktojmë këtë, ose ta shtyjmë për ditën e nesërme, sepse konditat e punës nuk janë më normale në sallë, konditat fizike. Prandaj, ju lus të keni kujdes. Edita Tahiri e ka fjalën, le të bëhet gati Fatmir Rexhepi.

EDITA TAHIRI:

Të nderuar, raportet e Ministrisë dhe të Komisionit ishin të mira, por gjendja në arsim nuk është e mirë. Prandaj, kujtoj se sot kjo duhet të jetë çështje: të gjejmë format e diskutimit, kreativitetit dhe rekomandimeve në mënyrë që sa më shpejt kjo çështje të ndryshojë. Reformat, si vizion i Ministrisë, natyrisht se janë të përkrahura dhe shprehin një shikim me largësi. Mirëpo, trendi i këtyre reformave është shumë i ngadalshëm dhe ai në radhë të parë nuk reflektohet në ndryshimet e jetës së mësimdhënësit, qoftë në kuptimin e jetës profesionale, ashtu edhe ekzistenciale.

Vonesa e nënshkrimit të Ligjit për arsim, sigurisht se ishte një faktor që ndikoi në këto trende. Politizimi, që është përmendur në raporte, nuk është zbërthye. Mendoj se ka nevojë pak më shumë të thuhet, sepse është fenomen që është krijuar, është bërë pengesë për cilësinë. Ka politizim në relacionin Ministri - Universitet, por ka politizim edhe më të madh brenda Universitetit, i cili po vazhdon, që nga paslufta.

Strukturat paralele. Mendoj se tani, pasi Ligji është nënshkruar, Ministria ka kompetencë, pra, të merret me këtë çështje dhe natyrisht derisa në një anë duhet të angazhohet të ndërpresë strukturat paralele, në anën tjetër, duhet të gjejë rrugën e integritetit të minoritetit serb në kuadër të Universitetit të Prishtinës.

Dhe, çështja e fundit, por më madhorja tanipërtani, pozita e palejueshme e dobët materiale e mësimdhënësve, e cila, për konsekuencë, ka krijuar cilësi në rënie në procesin e arsimit, demotivimin e mësimdhënësve, dhe në përgjithësi dobësimin e këtij segmenti vital të shoqërisë sonë.

Besoj se të gjithë pajtohemi se investimi në arsim është investim në ardhmërinë e Kosovës. Prandaj, më lejoni të konkludoj që ka nevojë për një përmirësim të shpejtë dhe substancial të pozitës materiale të mësimdhënësve dhe se desha të them që angazhimi i tashëm jo vetëm që është i pamjaftueshëm, por është për çdo kritikë. Nuk mund të lejohet që me 20% të rritjes, nuk e di a është e përkohshme apo e përhershme, ta përmirësojmë pozitën materiale të mësimdhënësve. Unë i kuptoj shpjegimet se buxheti i Kosovës është i limituar, por unë nuk mund të kuptoj që paga e mësimdhënësit dhe paga e ministrit të jenë me dhjetëherë diferencë, ju lutem. Pastaj, nuk mund të kuptoj që kemi deficit buxhetor dhe pastaj nuk dijmë me administruar dhe orientuar aty ku duhet deficitin buxhetor. Shpjegimet eventuale, se mësimdhënësit në Kosovë paguhen me lartësi të njëjtë si në rajon, janë të paqëndrueshme në rastin e mësimdhënësve të Kosovës. Mësimdhënësit dhe arsimi i Kosovës ishte shtyllë e rezistencës kundër okupimit dhe për pavarësimin e Kosovës. Prandaj, asesi nuk qëndrojnë krahasimet eventuale.

Dhe, në fund, më lejoni, edhe një rekomandim. Mendoj se në të ardhmen duhet të mendohet për një kompatibilitet midis kuadrove që po i krijojmë dhe nevojave që i kemi në ekonominë e Kosovës dhe në këtë kuadër mendoj se ka nevojë për një bashkëpunim më të madh midis institucioneve që duhet ta planifikojnë strategjikisht këtë çështje. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Fatmir Rexhepi, le të bëhet gati Ismajl Kurteshi, nëse s'ka heqë dorë. Kompliment Fatmir, Ismajl Kurteshi nuk heq dorë.

ISMAJL KURTESHI:

Zoti kryetar, zotri ministra, deputetë të nderuar,

Do të dëshiroja që situata në arsim, vërtet të ishte e mirë ashtu siç thanë disa diskutues, por unë do t'i bëj disa vërejtje ashtu siç i shoh.

Kushtet higjiëno-sanitare nëpër shkolla tona janë në një nivel vërtet të ulët dhe me këtë çështje do të duhej të merrej Ministria dhe të gjitha institucionet dhe këtu të bëhen korrigjime dhe përmirësime. Po ashtu, nëpër shkolla tona, ka edhe dukuri devijante dhe mosdisiplinë, siç është edhe përdorimi i duhanit, alkoolit, ndonjëherë edhe i drogës brenda objekteve shkollore, mosdisiplinë deri në shkatërrimin e objekteve të cilat janë përruar para 5-6 muajve dhe tash kanë filluar të riparohen, siç është rasti i Gjimnazit të Gjilanit, mbahen kurse të ndryshme, në lëndë të ndryshme dhe në një formë iu imponohen nxënësve edhe ata që s'kanë mundësi të paguajnë ato kurse.

Kam një pyetje për ministrin, ose së paku kështu në përgjithësi: kush duhet të kujdeset për mësimin plotësues të fëmijëve në mërgim për të cilët askush nuk kujdeset dhe propozoj apo sygjerohet që – konkurset për drejtorë të shkollave, përherë të shpallen gjatë pushimeve verore dhe të përfundojnë e të mos ndodhë sikur që ndodhi gjatë këtij viti shkollor që konkurset të hapen në nëntor dhe të mospërfundojnë asnjëherë dhe të ndikojnë shumë në procesin mësimor. Në shkolla tona mungon mekanizmi që përcjell dhe kontrollon punën dhe disiplinën gjatë procesit edukativo-arsimor, pra askush nuk hospiton nëpër orë dhe nuk dijmë as aspektin profesional në çfarë niveli mbahen orët, por edhe në aspektin e disiplinës dhe mungesave edhe të mësimdhënësve, edhe të nxënësve, edhe në çfarë forme e kryejnë punën edhe drejtorët dhe të tjerët.

Nëse i bëjmë këto mekanizma, a tëherë do të duhej të sigurojmë e dhe një infrastrukturë ligjore, e cila do të sanksiononte mospunën dhe jodisiplinën, pra do të ndikonte në rritjen e përgjegjësisë në punë dhe do ta dallonte punëtorin nga jopunëtori.

Do ta përmendi vetëm edhe problemin e paralelizmit, që u përmend. U fol për paralelizmin për shkollat në gjuhën serbe, të cilat do të duhej të zgjidhen në një formë dhe besoj se do të zgjidhen, por ekziston edhe një paralelizëm, sipas meje, e këto janë zyrtarë e Ministrisë nëpër komuna, ku veprojnë edhe drejtoritë e arsimit dhe ky është një paralelizëm, sipas mendimit tim, byrokratizim i cili vetëm i komplikon punët dhe nuk zgjedh asgjë.

Kurse, sa i përket kompensimit material të punëtorëve të arsimit, pajtohem me ata që thanë se vërtet këtë çështje duhet ta zgjedhim në mënyrë sa më të drejtë. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë. Melihate Tërmkollit, nëse s'ka heqë dorë, pastaj Mehdi Bardhi. Ashtu Mehdi, mirë e ke.

MELIHATE TËRMKOLLI:

Do të përpiqem shumë shkurtimisht t'i them dy-tri fjalë rreth kësaj teme të rëndësishme dhe që në fillim të mbështes Raportin e Ministrisë dhe po ashtu rekomandimet që ka bërë Komisioni për arsim, shkencë dhe teknologji i Kuvendit të Kosovës, natyrisht me plotësimet, të cilat do të bëhen nga diskutimet që po i bëjmë në këtë seancë.

Unë do ta them një çështje që lidhet me zbatimin e ligjit, dhe kujtoj se është një nga çështjet esenciale në punën jo vetëm të kësaj Ministrie dhe institucioneve, të cilave u referohet ligji, por edhe të ministrive dhe institucioneve të tjera. Dhe, unë kujtoj që

miratimi i ligjeve në Kuvendin e Kosovës, dhe fakti që kemi ne për arsimin e lartë në Kosovë, respektivisht, mosnënshkrimi i tyre nga Përfaqësuesi Special, kujtoj nuk i krijon askujt alibi që të punojë në mënyrë jointucionale. Prandaj, unë kujtoj që kërkesa edhe e këtij Kuvendi duhet të jetë puna vërtet institucionale dhe mbështetur në këto ligje.

Çështja e dytë, është pikërisht kjo që po diskutojmë për buxhetin respektivisht financat në arsimin e Kosovës. Dhe, unë kujtoj se është detyrë dhe i referohet jo vetëm Ministrisë, por gjithë Qeverisë së Kosovës, por edhe institucioneve të tjera – hartimi i një strategjie kombëtare për arsimin, si bazë e zhvillimit të shoqërisë së Kosovës dhe jo si pengesë në zhvillimin e kësaj shoqërie.

Ne dëgjuam para dy-tre ditëve një deklaratë, kujtoj shumë të pamoralshme, se shtimi i pagave për arsimtarët prej 10 a 20% qenkan një pengesë për 7-8 mijë vende të punës apo njëra a tjetra. Kujtoj është shumë e pamoralshme dhe arsimtarit tonë, megjithëpunën, megjithsakrificat, nuk mund t'i thuhet një kushtëzim i këtillë dhe nuk mund t'i jipet përpara se ne ja po i shtojmë pagat, por ju po ndalni bukën e 7 mijë njerëzve të tjerë të cilët do të punësoheshin. Jo 20% por një përqindje shumë më e lartë i takon arsimtarëve tanë sepse ata e meritojnë dhe duhet ta meritojnë dhe unë kujtoj se duhet të jemi shumë të kujdesshëm edhe në deklaratat por mbi të gjitha në veprimet tona.

Dhe, së fundi, kam një pyetje për ministrin, çështjen e vijimit të mësimin fillor. Unë do të doja vërtet, sa ka informacione Ministria edhe ministri, për vijueshmërinë apo mos ka shmangie nga vijimi i mësimin në arsimin fillor.
Ju falemnderit shumë.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë. Xhezair, nëse s'ke heq dorë, pastaj Gjulshen Berisha.

DŽEZAIR MURATI:

Poštovani predsedniče i kolege,

Ja, kao i prethodni govornici, podržavam Izveštaj Ministarstva, naravno i preporuke Komisije ove Skupštine za obrazovanje i saglasno zakonima koje smo ovde usvojili kao i podršci procesu započelih reformi, zadržao bih se na stalnom unapređivanju kvaliteta rada u obrazovanju ali i adekvatnom nagrađivanju nastavnog osoblja.

Najprije da kažem da smo u započetoj reformi ulagali i ulažemo dosta truda. Dobro je što su nam u tome pomogla neka ministarstva nekih zemalja, kao što je ove godine bio slučaj sa Slovenijom, prilikom izrade novih nastavnih planova i programa, rukovodeći se logikom da se ne treba baviti otkrivanjem vode ako je već neko pre toga otkrio, je'l tako. Mnogo truda je uloženo u tome i učestvovali smo naravno i gotovo svih ostalih zajednica, pa je dobro da taj proces teče, traje, pa i uz još veće napore, jel tako, i uvek naravno, dobrodošla nam je pomoć i sa strane, ako je ona dobronamerna, kako je to ovoga puta bilo. Međutim, primetio bih da još uvek malo više robujemo teoriju obrazovanja jer sam i sam radnik u obrazovanju i da praksa ne prati dovoljno te teoretske novine u obrazovanju. Zato, uz našu

dobru volju, dekvatne kadrove, potrebna su i velika sredstva u opremanju sala, radionica, očiglednih sredstava i takodalje. Ne može se u reforme ići i sprovoditi ih ako je praksa ne prati najmanje u istoj onoj meri i vremenu koje smo uložili i u teoretskom, kažem u teoretskim saznanjima. Priznaćete da to nije nimalo lako i da mnogo, izuzetno mnogo sve to košta. Kako doći do sredstava, kako opreмати škole, ako za četiri igodine gotovo ni za centa nismo podigli materijalni položaj zaposlenih u obrazovanju. Da li da i dalje dozvoljavamo da prosvetni radnici, što su neki prethodnici ovde govorili, mislim gospodin «simon» preživljavaju preko toga, ili običnog fizičkog rada na trotoarima i tako dalje, mislim da je tu dinjitet odnosno ugled nastavnika svih nivoa kako je i rećeno na taj način, moraju oni da ga saćuvaju pred svojim vaspitanicima i normalno da... a ti isti ljudi moraju od nećega da žive pa su prinuđeni i na takvu vrstu, da ne kažem poniženja, ali mi moramo izuzetno znaćajan segment ovog društva u svakom pa i u kosovskom društvu je li.... Kažem nisu li u koaliziji ova dva zahteva sprovođenje reformi i neadekvatno nagrađivanje. I na kraju, ne zaboravimo neka ta sredstva budžeta Kosova odlaze u bure koje nema dno, za koje nemamo nikakvu transparentnost trošenja a potpuno nam nedostaju tamo gde bi morala biti a to je u reforme i u mladost i u ono, jeli, bez ćega nijedno društvo, pa ni kosovsko ne može a to je proces obrazovanja. Hvala.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Gjushen Berisha, nëse s'heqë dorë dhe le të përgatitet Exhlale Salihu.

GJULSHEN BERISHA:

Më duket se në arsim janë të kyçura më tepër femrat dhe kjo reflektohet edhe në marrjen e fjalës në këtë seancë. Por, dola në foltore me një qëllim shumë të mirë, për ta mbështetur dhe për të përshëndetur Raportin e punës së Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe Teknologjisë si dhe ministrit përkatës, si një Raport, a dokument i parë i dorëzuar i punës njëvjeçare në Kuvendin e Kosovës dhe të gjithë deputetëve.

Raporti është gjithpërfshirës ku shprehen të gjitha sukseset dhe të arriturat në arsim, por natyrisht këtu shprehen edhe vështirësitë me të cilat ballafaqohet arsimi në të gjitha nivelet e organizimit të saj. Angazhimi i Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe Teknologjisë dhe rezultatet e saj janë në vënien e rendit dhe të disiplinës në institucionet shkollore përmes ligjeve në fuqi që rregullojnë lëmin e arsimit në të gjitha nivelet dhe që ndërton raportet e të drejtave dhe përgjegjësiive në mes institucioneve të të gjitha niveleve, pushtetit komunal dhe atij qendror. Angazhimi i Ministrisë për ngritjen permanente të cilësisë në arsim, duke kërkuar angazhimin e plotë të mësimitdhënësve për transformimin dhe reformimin permanent të sistemit arsimor. Këtu vjen në pah politika gjithpërfshirëse në të cilën të gjitha palët e involvuara japin kontributin e vet në procesin e reformave dhe shohin vetëveten si pjesë të reformave. Andaj, çështja e arsimit nuk është vetëm çështje e Minsitrisë së Arsimit, të Shkencës dhe Teknologjisë, por është me rëndësi të kuptojmë se shoqëria në tërësi është bashkëpërgjegjëse me prindërit në zhvillimin e fëmijëve dhe arsimin e tyre. Jemi përgjegjës për jetën e tyre, andaj duhet të investojmë këtu, të investojmë e të moskursejmë, sepse investimi në arsim do të na paraqitet me t'kursyer në të ardhmen.

Dhe, gjithashtu do t'i mbështes disa rekomandime, sidomos rekomandimin e zoti Bajramit, për participimin në shkolla të mesme, ku do të bënin përjashtim familjet në asistencë sociale. Pastaj, angazhimin në infrastrukturë, gjetja e fondeve për ndërtim të objekteve shkollore, që ora mësimore të jetë 45 minuta, që nxënësit e talentuar të kenë orë plotësuese, por edhe nxënësit tjerë të cilët kanë nevojë për mësim më tepër. E gjithë kjo do të bëhet në qoftë se kemi sigurimin e bazës materiale dhe sigurimin e hapësirës shkollore. Gjithashtu duhet përfshirë edhe tetëorëshi i punëtorëve të arsimit.

Mendoj se me këto rekomandime dhe ato të tjerat që janë dhënë nga deputetët tjerë janë rekomandime të cilat mund t'i gjejmë ndoshta edhe në planin strategjik të Ministrisë së Arsimit. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën Exhlale Salihu.

EXHLALE SALIHU:

I nderuar zoti kryetar, zotri ministra dhe kolegë deputetë,

Do të jem sa më e shkurtër, që t'i përmbahem rregullit. Megjithëse aksenti kryesor është në arsimin në Kosovë dhe meqenëse jam e lidhur drejtpërdrejt me shkencë, ndiej obligim të flas shkurt lidhur me këtë çështje. Konkretisht për Institutin Albanologjik, institut ky me rëndësi të veçantë kombëtare ku edhe punoj.

Në Raportin vjetor të Minsitrisë, të cilin edhe e përshëndes, flitet për punën njëvjeçare të këtij Instituti, dhe në fund, thuhet me sa vijon, do të citoj: «Institutin Albanologjik, nuk u nënshtrohet rregullave të Ministrisë së Arsimit, të Shkencës e të Teknologjisë lidhur me organet drejtuese të Institutit». Këtu, në fakt, fjala është për emërimin e drejtorit të këtij Instituti. Institutin Albanologjik është shumë kooperativ dhe transparent, çka vërteton edhe fakti se që në fillim të themelimit të Minsitrisë përkatëse ka kontaktuar me vetë ministrin, për çka kam edhe shkresat këtu, s'është nevoja me ua tregu, këtu te unë gjenden, gjë që demanton atë që Institutin nuk u nënshtrohet rregullave të Ministrisë, por Institutin kërkon që të rrespektohet ligji për Institutin Albanologjik dhe për veprimtarinë kërkimore-shkencore të Kosovës, të cilët janë ende në fuqi dhe në bazë të të cilëve është duke vepruar deri te aprovimit të ligjit të ri për shkencë, i cili është në përgatitje.

Do të cek se Institutin është një nga institucionet e para që ka kërkuar të bëhen transformime në veprimtarinë kërkimore-shkencore në përgjithësi dhe në Institutin në veçanti menjëherë pas konstituimit të Ministrisë, por për këtë ka kërkuar që më parë të miratohen kriteret dhe ligjet përkatëse. Sa për veprimtarinë shkencore të Institutit, do të thosha se ajo e tëra nuk është përfshirë në Raport, mirëpo mendoj se jeni të informuar për veprimtarinë e madhe të Institutit, por me siguri natyra e Raportit të punës ka qenë ashtu që të jetë sa më e shkurtër.

Përkundër këtyre «mosmarrëveshjeve» në thojza, në fund do të them se Institutin ka pasë mirëkuptim dhe sot është duke zhvilluar një bashkëpunim të mirë me Ministrinë tonë, aq të pritur, të cilën edhe e falënderon për përmirësimin e gjendjes materiale, sadopak të

punëtorëve të tij në këtë vit, të cilët, përdallim të të gjithë punëtorëve të arsimit të lartë, kanë qenë të dëmtuar deri më tani me paga.

Me këtë rast, lus ministrin e nderuar që të ketë gjithnjë parasysh gjendjen financiare të Institutit Albanologjik, e edhe të instituteve tjera, mendoj të natyrës së njëjtë.

Jam e bindur se ky bashkëpunim gjithnjë e më tepër do të thellohet në të mirë të shkencës dhe të Kosovës në tërësi.

Në fund, më lejoni ta them një fjali lidhur me arsimin në përgjithësi. Ne flasim gjithnjë për reformat në punën e arsimit. Ju lutem shumë, mendoj se duhet bërë reforma të përgjithshme në ndërgjegjen tonë dhe të të gjithë kosovarëve që arsimit të ketë vendin e duhur. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Do të doja të tërheq vëmendjen tuaj në një çështje. Përmirësimi i cilësisë së punës në Parlament, në të gjitha nivelet, dhe në Sekretarinë, për kushtet e punës apo edhe lëshimet eventuale që kemi pasë, në mesin e të të gjithëve, i takon edhe zotit Franck Buolin, ish sekretarit gjeneral të Parlamentit dhe tash këshilltar i Parlamentit të Kosovës, sepse është seanca e fundit e tij që merr pjesë me ne. Dëshirojmë që të vazhdojmë një bashkëpunim me këshilltarë të këtillë ndërkombëtar, ndërsa Franck Buolin i dëshirojmë të gjitha të mirat në Parlamentin Nacional në Francë dhe se në projektet e ndryshme të jetë gjithmonë me ne dhe të jetë një avokat i ecjes së progresit të këtij Parlamenti.

(Duartrokitje)

Dhe, më lejoni që një fjali, edhe unë, si deputet në këtë rast. Pyetjet do të shtrohen dhe do të ketë përgjigje ministri.

Duhet të nxirret sa më parë ligji mbi shkencën dhe institutet shkencore dhe Akademia ta ketë trajtimin e vet dhe atëherë do të keni propozime shumë të mira që nga Buxheti i Kosovës, ashtu siç e kanë krejt vendet në botë, do të ndahet sasi e caktuar e mjeteve për shkencë.

Unë do të përfundoj me këtë. Do t'i përkrah të gjitha nismat që Universiteti t'i ketë zgjidhjet e asaj pos nën a) dhe nën b) dhe nëse ka nevojë... Kjo duhet të vlejë edhe për arsimin e mesëm, në veçanti atë profesional, një obligim më i madh i komunave, ato që kanë mundësi dhe të mos hezitojnë ta ndihmojnë mësimdhënien dhe mësuesit atje.

Dhe në fund, meqë i përkrahëm të gjithë rekomandimet,

Kush është për Rekomandimet e Komisionit për arsim, shkencë e teknologji, kuptohet me të gjitha vërejtjet dhe propozimet cilësore, të cilat i dorëzohen Komisionit. Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka votë kundër.

A abstenon ndokush? Një abstenim. Ju falemnderit.

Votimi – Glasanje – Voted:

- Për – Za – For -	Shumica – Veçina – Majority ...
- Kundër – Protiv – Against.....	00
- Abstenuan – Uzdrzanih – Abstained.....	01

Po vazhdojmë me pikën vijuese të rendit të ditës – **Miratimi i Propozimit për emërimin e anëtarëve në komisione parlamentare.**

Ju keni propozimet, Grupi Parlamentar i PDK, por kjo do të thotë – i aprovojmë dhe ka qenë një lutje që kryetarët e grupeve parlamentare le ta analizojnë pjesëmarrjen e deputetëve në komisione dhe atje ku komisionet kanë qenë të dëmtuara le t'i zëvendësojnë menjëherë dhe të rrisin efikasitetin e punës së Parlamentit.

Duhet formalisht t'i votojmë ndryshimet në komisione.

Kush është për propozime të grupeve, që janë aprovuar edhe në Kryesi? Ju falemnderit. Kundër nuk ka. Ju falemnderit.

Votimi – Glasanje – Voted:

- Për – Za – For	Të gjithë – Svi – All
- Kundër – Protiv – Against	00
- Abstenuan – Uzdrzani – Abstained.....	00

Dhe pika e fundit - **Parashtrimi i pyetjeve.**

Ramadani ka ndonjë pyetje sigurisht. Urdhëro Ramadan dhe në qoftë se ke për pyetje, kryeministri ka paralajmërua javën e ardhshme do të përgjigjet në to.

RAMADAN KELMENDI:

Unë ju kërkoj falje, por jam i shtrënguar që ta kërkoj të drejtën time si deputet për faktin se: me datën 28. 5. 2002 Kryesisë së këtij Kuvendi iu kam drejtuar me një propozimligj që është mjaft i rëndësishëm dhe nuk di sa ka arsye ta elaboroj rëndësinë e tij. Propozimligji është ky – Projektpropozimligji për shpalljen e personave si të zhdukur, të vdekur dhe promovimin e vdekjes. Nga fakti se shumë qytetarë nuk mund t'i realizojnë të drejtat e tyre

trashëgimore, pastaj pronësore-juridike dhe nga shumaspekte tjera dhe për të njëjtin as që kam marrë ftes që të them ndonjë fjalë për arsyeshmërinë e tij por as nuk ka hyrë në procedurën që ne marrim si ligj të tillë, a duhet apo nuk duhet... Unë e di që duhet dhe nëse ky s'i plotëson kriteret, është pika më e padiskutueshme, por ky ligj na duhet.

Dhe, e dyta, po ashtu po bëhen tani sa muaj, më 15. 3. 03. tri pyetje esenciale që kanë të bëjnë me një problematikë mjaft përmbajtësore, i jam drejtuar po ashtu Kryesisë, vërtet Qeverisë së Kosovës dhe ai akoma s'ka gjet arsyeshmëri që të marrë përgjegje me gojë. Dhe, këto janë: Cilat janë arsyet apo faktet e mosrealizimit të asnjë marrëveshjeje, të nënshkruar nga UNMIK-u dhe faktori vendor, në nivel qendror dhe atë lokal, lidhur me integrimin politik, ekonomik, juridik, kulturor, arsimor të qytetit të Mitrovicës, i cili është përplot i përmbushur me probleme dhe përkundër faktit se kemi deklarata se atje ka lëvizje të lira... e tjera, e tjera.

Dy, cilat janë veprimet konkrete të Qeverisë për sigurimin e qytetarëve të lagjeve veriore, ku nuk ka siguri kurrfare.

Dhe, e treta, cila tjanë shkaqet që 26.830 shqiptarë të pjesës veriore, të cilët janë të shpërngulur me dhunë nga serbët, nga pronat, banesat dhe shtëpitë e tyre anëkënd të Kosovës dhe më gjerë dhe nuk lejohen kurrësi të kthehen në banesat, pronat dhe shtëpitë e tyre, të fillojnë rindërtimin edhe për shkak të donacioneve të marra, ndërsa në anën tjetër, të njëjtëve nuk iu njihet as e drejta e refugjatit, ndërsa serbëve iu njohet të gjitha këto të drejta.

Ju falemnderit. Kërkoj përgjigje, jo me shkrim, por me gojë në këtë Kuvend.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Unë mendoj se e drejtë është dhe duhet të përgjigjen ata të cilët...

Vazhdojmë, është konfirmuar përgjigja gojore e ministrit të tregtisë dhe të industrisë, zotit Ali Jakupi, në pyetjen e deputetit Ismajl Kurteshi. Zoti ministër, urdhëroni.

ALI JAKUPI:

E nderuara Kryesi, të nderuar deputetë,

Kam nderin që t'i përgjigjem pyetjes së deputetit, zotit Ismajl Kurteshi. Ai ka shtruar dy pyetje me datën 30.5. dhe ato kanë të bëjnë me, e para: Shtrenjtimin e bukës dhe të ujit në komunën e Gjilanit dhe e dyta: Ç'ka ndodhur dhe ç'është ndërmarrë me Ndërmarrjen «Eximkos» dhe «Gragjevinar».

(Vërejtje e Kryesuesit: Seanca, nuk ka përfunduar, ju lutem!)

Ne menjëherë kemi bërë, posa kemi marrë pyetjen me shkrim, dhe angazhuar organet përkatëse të Ministrisë, kanë bërë hulumtimet dhe kanë ardhur në konstatim se shtimi i

bukës në 30 cent të bukës prej 500 gramësh, pothuaj, është e njëjtë si çdokund, ndërkaq, shtimi i çmimit të ujit është bërë në Gjilan për 100%, do të thotë prej 15 centësh në 30 centë për një metër kub dhe se përgjigja jonë është se të gjitha këto shtrenjtime janë bërë nga vetë organet komunale, sepse mbështetjen e kanë në Rregulloren 2000/45, përkatësisht në kapitullin 1, neni 3, a lineja f) dhe l) të kësaj Rregulloreje që rregullon kompetencat vetëqeverisëse të komunave. Do të thotë, ne përkundër faktit se Ministria ka shërbimet dhe zyret për mbrojtjen e konsumatorëve, të gjitha këto çështje janë në kompetencë të komunave. Domethënë, përgjigja jonë është e tillë dhe se bordi, i cili ka ngritur çmimin e ujit, është i emëruar nga AKM, do të thotë nga Agjencioni i Mirëbesimit Kosovar.

Përgjigjet në pyetjet tjera. Me datën 12.6.2003 në bordin e Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit është shqyrtuar situata në «Eximkos» lidhur me shitjen e aseteve në Beograd e gjetiu. Po ashtu është shqyrtuar edhe çështja e «Gragjevinarit» një ndërmarrje në Shtërpcë, në komunën e Shtërpcës, e cila është privatizuar dhe është blerë nga drejtori i asaj ndërmarrjeje. Janë ndërmarrë masa në atë mbledhje, kam qenë edhe unë prezent dhe se aty janë aplikuar masat e drejtpërdrejta, që do të thotë se për fajësinë tjetër, është duke punuar zyra ligjore e AKM dhe çfarë gradacioni, çfarë niveli të keqpërdorimeve deri në kriminalitet do të ndërmirren masa të mëtutjeshme. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit zoti ministër. Është konfirmuar përgjigja gojore e ministrit të kulturës, zotit Behxhet Brajshori, në pyetjen e deputetit Alush Gashi. Zoti ministër, fjala është e juaja.

BEHXHET BRAJSHORI:

I nderuar kryetar, të nderuar deputetë,

Falënderoj zotin Gashi, deputetin për pyetjen e parashtruar, e cila konsiston në..., Pyetja është: Çka ka ndërmarrë Ministria për ta mundësuar vazhdimin e aktivitetit të Qendrës së Pionierëve në Prishtinë? Me fjalë tjera, nuk është Qendra e Pionierëve, por është Qendra e Rinisë. Sipas shkrimeve, ajo është kërcnuar se do të mbyllet dhe përgjigja është me sa vijon, për të mos humbur kohën:

Pas definimit të përgjegjësive në mes të Qendrës Rinore, Pallatit të Rinisë dhe Komunës, dhe me ndërmjetësimin e Ministrisë, është arritur marrëveshja që Qendrës Rinore t'i mundësohet vazhdimi i kontratës mbi shfrytëzimin e objektit në Pallatin e Rinisë deri në muajin shkurt të vitit 2004.

Mbetet një aktivitet shtesë i Ministrisë dhe i komunave në përgjithësi për të gjetur zgjidhje të qëndrueshme për të gjitha qendrat rinore në Kosovë. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju Falemnderit.

Kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës – Propozimi i rendit të ditës për Seancën plenare më 3 korrik 2003:

- Shqyrtimi i procesit të privatizimit;
- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për prokurimin publike; dhe
- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për planifikim hapësiror.

Urdhëroni, zoti Rrustemi.

SABIT RRUSTEMI:

Zoti kryetar, të nderuar deputetë,

Ne, ka kohë, që si Komision parlamentar për media, kemi bërë kërkesë për një debat në këtë Kuvend për çështjen e «Rilindjes» dhe të gjitha medimeve tjera që më herët Kuvendi i Kosovës ka qenë themelues i tyre. Të njëjtën kërkesë unë shpreh edhe këtu para jush dhe propozoj që edhe në seancën e ardhshme, meqë tash do të shkojmë në pushim, sigurisht pas kësaj apo tjetrës seancë, që kjo çështje të hyjë në rend të ditës për debatim. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Kryesia do ta shqyrtojë. E ka fjalën Edita Tahiri.

EDITA TAHIRI:

Unë, po ashtu, kam një propozim për një çështje që duhet të hyjë në rend dite, e është fjala për gjendjen e rëndë në PTK të Kosovës dhe kjo gjendje, siç e dijmë, është një kohë të gjatë e përshkuar me fenomene, por sidomos me suspendimin e drejtoreshës Leme Xhema dhe mendoj se është koha që kjo çështje të hyjë në rend dite. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Le të shkojë me procedurë të rregulltë.

Ju falemnderit për pjesëmarrje dhe kontribut. Shihemi në javën e ardhshme.

Seanca përfundoi punën në orën 14,40.

E transkriptoi RT, z.E-04